Dhuratë e revistës Etika

Besë

Viti 2 • Numri 7 • Korrik-Shtator 2014

O BESIMTARË!

JU ËSHTË URDHËRUAR

Agjërimi

ashtu siç ju ishte urdhëruar atyre që ishin para jush

që të mund të ruheni nga të këqijat.

(Bekare, 183)

şimşek
Hayatın Tatlı Yanı...
Bien
Croissant
Bien
Croissant
Bien
Croissant
Tio
Ring
Paradise
Chocolate Chip Cookies
Roxy
Roxy
Fıstıklı
www.lalgrup.com
www.simsek.com.tr

Ramazani është muaji i shenjtë që na kujton të mirat që zotërojmë dhe na mëson si të jemi falënderues për këto. Në këtë muaj ne heqim dorë nga kënaqësitë materiale për të fituar kënaqësi shpirtërore. Ashtu si namazi edhe agjërimi na largon nga veprat e këqija dhe mëkatet; ai na afron me Allahun.

Ramazani është muaji i mëshirës dhe bujarisë. Ai na mëson të mendojmë për të varfrit dhe ta mbushim zemrën tonë me ndjenja dashurie për njerëzit e tjerë. Zemra pastrohet. Ndjenjat tona të mira forcohen.

Agjërimi është ilaçi i shumë sëmundjeve fizike dhe morale. Tepricat që ndodhen në trupin tonë hidhen jashtë me anë të agjërimit, nga ana tjetër agjërimi ndihmon në zvogëlimin e mëkateve. Njerëzit me anë të agjërimit arrijnë një shkallë të tillë pastërtie duke u bërë të denjë për të kaluar nga dyert e xhenetit.

Agjërimi është mënyra më e mirë për t'i tregua dashurinë tonë Allahut, sepse njerëzit që agjërojnë vetëm për hir të Allahut e kushtëzojnë veten dhe qëndrojnë larg mëkateve dhe të këqijave. Njeriu që agjëron shpërblehet nga Allahu për këtë adhurim të bërë.

Siç ka thënë Shakiki Belhi:

"Kryerja e adhurimit ashtu siç duhet është një art i veçantë që kërkon aftësi të veçantë."

Mevlana i nderuar ka thënë:

"Ushqimi i vërtetë i një njeriu është drita e Allahut. Ushqimi i trupit me produkte të yndyrshme dhe të ëmbla nuk i bën mirë trupit. Ushqimi i njerëzve të mirë është dashuria hyjnore."

Bashkëshortja e nderuar e Pejgamberit tonë të nderuar, Hazreti Aishe ka thënë:

"Bëni përpjekje për të hapur derën qiellore!"

Njerëzit e pranishëm e kanë pyetur: "Si?"

Ajo i është përgjigjur: "- Duke qëndruar pa ngrënë dhe pa pirë!.."

Nga kjo kuptojmë se nuk është mirë ngrënia deri në mbingopje. Njerëzit e dashur të Zotit na kanë mësuar se duhet ngrënë pak, fjetur pak dhe folur pak.

Në këtë mënyrë para nesh hapet një derë e rëndësishme prej të cilës mund të fitojmë shumë. Le ta ruajmë gjuhën tonë nga gënjeshtrat, thashethemet, shpifjet dhe marrja nëpër gojë; le ta ruajmë zemrën tonë nga urrejtja, zilia, krenaria dhe ambicia e tepruar; le t'i ruajmë të gjitha gjymtyrët tona nga mëkatet dhe gabimet dhe duke shpresuar në faljen e gabimeve që kemi bërë le të mundohemi për të qëndruar të pastër dhe të drejtë.

Le ta mësojmë gjuhën tonë me dua, kërkesë për falje dhe me fjalën e dëshmisë. Gjatë këtij muaji të bekuar le të punojmë për të fituar xhenetin... Le të qëndrojmë larg mëkateve, në mënyrë që të shpëtojmë nga xhehenemi, le të bëjmë të mira aq sa kemi mundësi në mënyrë që t'i afrohemi xhenetit. Le të bëjmë përpjekje për të fituar duanë e njerëzve që vuajnë dhe që janë në gjendje të vështirë. Le të fitojmë sevape duke i ftuar në sofrat tona të Ramazanit njerëzit e varfër. Allahu na bëftë nga njerëzit që e kalojnë në Ramazanin në mënyrën më të dobishme të mundur!

Amin!..

BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Ernida Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime. com

VITI: II
NUMRI: 7
Korrik-Shtator
2014

Përmbajtja

Terapia që vjen nga qielli 17
Fatma Alladag

Namazim, eliksiri i myslimanit 20
Osman Nuri Topbash

Farat e rrushit 38
Nezhla Bash

Syfyri dhe Iftari 26
Dr. Betyl Nefise Inall

Shkallët e edukimit gjatë Ramazanit 10
Seher Ajdën

Katër librat e shenjtë 28
Neslihan Nur Turk

Agjërimi 12
Melike Shahin

Në fund më bëri dobi vetëm Ilmihali 30
Halime Demireshik

Le të kthehemi 5
Fatma Hali Liman

Ramazani në zemrën time prej fëmije 18
Kybra Çoban

Vendosja e unazës 34
Kevser Atar

Të qëndrosh para portës së faljes 7
Zahide Topçu

Le të ndriçojë drita jote 24
Shefika Kaja Meriç

Koha e faljes dhe mëshirës 37
Tuba Sökmen

Ramazani muaji i adhurimit 8
Fatma Nur Xhihan

Le të kthehemi

Fatma Hali Liman

Muaji i bekuar i Ramazanit është muaji që e presim me dua që në muajin Rexhep.

Herë pas here përsërisim duanë e Pejgamberit tonë të dashur: *"O Allah bekoji muajt tonë të Rexhepit dhe të Shabanit, bëj që të arrijmë shëndosh e mirë në muajin e Ramazanit."* Kushedi sa herë e përsërisim këtë dua gjatë dy muajve të bekuar.

I lutemi Zotit që Ramazani të na gjej shëndosh e mirë. Po çfarë bëjmë ne kur vjen ai muaj i bekuar? Dihet që Pejgamberi ynë i nderuar e priste bashkimin me Ramazanin plot dashuri, siç pret një njeri takimin me njeriun e zemrës. Ai e priste me mall ardhjen e Ramazanit...

Çfarë bën njeriu kur bashkohet me të dashurin? Dashuria është diçka personale. Askush nuk dëshiron që ta ndajë me të tjerët dashurinë e vet. Ato e heqin mallin në vetmi. Të dashuruarit dëshirojnë që ta kalojnë çdo çast me njëri- tjetrin, të largojnë mallin. Le të pyesim veten: teksa ne gëzohemi për ardhjen e tij, a gëzohet ai muaj i bekuar nga veprat tona...

Ky takim i bukur fillon me teravinë e natës së parë të Ramazanit dhe përfundon me iftarin e fundit. Çdokush merr pjesë aq sa meriton, aq sa ka punuar dhe sa ka bërë përpjekje. Nganjëherë Ramazani kalon shumë shpjet, ne nuk arrijmë që ta kuptojmë rëndësinë e tij dhe nuk arrijmë që të përfitojmë prej tij. Ditën e fundit të tij e kalojmë me pendimin që nuk e kemi shfrytëzuar si duhet atë.

"I dashuruari respekton të dashurin.", - thotë gjuha jonë... Le të mendojmë se si e priste Pejgamberi ynë Ramazanin dhe si e harxhonte kohën gjatë tij, pastaj t'i hedhim një sy jetës sonë gjatë Ramazanit...

Gjëja më e rëndësishme që duhet të kuptojmë është se Ramazani është muaji nga i cili duhet të përfitojmë për të bërë vepra të mira të cilat na ofrojnë me xhenetin. Është mëkat t'i kalosh ditët e çmuara të Ramazanit në dyqane dhe në vende të cilat nuk na sjellin asnjë dobi.

Në kohët e mëpërparshme edhe përgjegjësitë e skllevërve pakësoheshin, në mënyrë që edhe ato të kishin kohë për të qëndruar vetëm për vetëm me Allahun... Le të qëndrojmë sa më shumë në mesxhidet e xhamive dhe sa më pak në rrugët e padobishme.

Le të bëjmë dua sa më shumë ... Le t'i shërbejmë njerëzve dhe gjithë gjallesave të tjera. Le të përgatisim iftarin tonë me ato gjëra që kemi në shtëpi, pa e tepruar. Le të ftojmë në sofrën tonë të iftarit

miqtë tonë të dashur, të afërmit tonë por edhe njerëzit e panjohur që kanë nevojë për një ndihmë të tillë. Le të shtrojmë iftare vetëm me dëshirën dhe shpresën për të fituar sevape...

Pas namazit të teravisë të falur në xhami ose në shtëpi le të bëjmë përpjekje për të pushur sa më mirë në mënyrë që të jemi gati për syfyrin që vjen, sepse me të do të filloj një ditë e re e Ramazanit e cila pret të mbushet me lutje dhe me adhurim.

Sa keq që jemi bërë kaq njerëz dembelë. Tashmë edhe shtëpitë tona na duken të ngushta. Mysafirët nuk i presim në shtëpi por në restorante e lokale. Nuk i gatuajmë vetë ushqimet por i marrim të gatshme. Nuk i shërbejmë më miqve tonë, tashmë shërbejnë kamerierët, ne vetëm paguajmë paratë.

Ndërkohë familjet që shtojnë sofrat e iftarit në shtëpi bëjnë harxhime të shumta në mënyrë që çdo gjë të duket sa më bukur. Sigurisht që njerëzit me zemër të gjerë dhe me mundësi të përshtatshme duhet të përfitojnë nga kjo gjë dhe të shtojnë sofra sa më të bollshme. Ato nuk janë njerëz të cilët kërkojnë që të duken mirë tek të tjerët... Ato janë njerëz që lumturohen kur gjejnë mundësi që të ndajnë me njerëzit e tjerë të mirat që u ka dhuruar Zoti. Edhe në këtë rast duhet bërë kujdes që kjo vepër të mos bëhet për hipokrizi, gjithashtu duhet të bëhet kujdes që të mos bëhen shpërdorime. Nuk është mirë që të mbushen përplot sofrat të cilat nuk konsumohen dot dhe ushqimet e saj të hidhen në mbeturina. Nuk mund të bëhet kjo gjë në një botë ku akoma ka njerëz të cilët e kalojnë të gjithë ditën pa futur asgjë në gojë...

Një njeri që dëshiron të bjerë në sy të atyre që e rrethojnë e kalon Ramazanin mes komplekseve... Sa e vështirë është të falet namazi me një stomak të mbushur aq sa nuk mban më, por sa bukur është ndjesia e faljes së namazit me stomakun e lehtë...

Çdokush gjatë Ramazanit mundohet që të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme... Kushdo që pyetet, përgjigjet se po e vlerëson Ramazanin më së miri!..

Ne a nuk do ta kalonim muajin e shumëpritur të Ramazanit në vetmi, të zhytur në adhurimet tona?! Por si gjithmonë i kalojmë ditët e bekuara të Ramazanit me argëtime të pavlera dhe punë të padobishme...

Jam shumë kureshtare të di se çfarë mendojnë njerëzit kur janë duke përcjell muajin e Ramazanit; a ka një dhimbje dhe një boshllëk në zemrat e tyre?!

Duhet të kthehemi në shtëpitë tona, duhet të largohemi nga sytë e botës. Le të tregohemi modest dhe të përkushtohemi ndaj adhurimeve tona. Mos ta harxhojmë kohën tonë me argëtime të pavlera por të përpiqemi me të gjitha forcat tona për t'u bërë njerëz më të mirë dhe rob të denjë të Allahut. Orët e çmuara që duhet t'i kalojmë me të Dashurin tonë të shenjtë mos t'i harxhojmë me egon e pavlerë... Ne nuk bëjmë asgjë tjetër veçse i tregojmë egos sonë se sa e rëndësishme është për ne dhe sa shumë përpiqemi për ta kënaqur atë... Në një vend të udhëhequr nga egoja a mundet muaji i Ramazanit të shfaqë të gjithë begatinë, shkëlqimin dhe bukurinë? Ai sillet sipas rëndësisë që i jepet, nëse ti i jep rëndësi edhe Ramazani të jep rëndësi ty pastaj kur vjen koha largohet i qetë...

Le të kthehemi në shtëpitë tona!..

Shtëpitë tona, sofrat tona begatohen nga duatë që bëjnë njerëzit të cilët i ftojmë në iftar; ato shndërrohen në kopshte xheneti...

Në xhami le të shkojmë për të falur namazin me xhemat; kohën që mbetet le ta kalojmë në shtëpi duke adhuruar Zotin tonë... Ne kemi nevojë për çaste të tilla... Fëmijët tonë, bashkëshorti, miqtë kanë nevojë për këto çaste... O Allah mos na privo...

Të qëndrosh para portës së Falës

Zahide Topçu

Një njeri i cili ka përsipër gabimet që ka bërë kundrejt njerëzve të tjerë e ka të vështirë që të afrohet me Allahun (xh.sh.).

Njeriu nuk duhet të përsëris një gabim për të cilin është penduar njëherë. Thuhet se mëkati i vogël nuk qëndron bashkë me këmbënguljen në këtë gabim dhe as mëkati i madh nuk mund të qëndrojë me pendimin.

Një njeri i cili e ka prishur shumë herë pendimin e vet nuk duhet të dorëzohet, ai duhet të vazhdojë me kërkimin e pendimit sepse nuk ka asnjë derë ku mund të trokasim përveç derës së Allahut (xh.sh.). Shejtani e mashtron njeriun dhe e çon atë në humbje duke thënë: "Ti je penduar kaq herë dhe përsëri ke vazhduar me gabimet e tua, tashmë nuk të pranohet pendimi "...

Kur njeriu dëshiron shumë që të mos e përsëris atë gabim dhe mundohet me të gjitha forcat e veta për ta arritur këtë gjë por nuk ka sukses atëherë nuk mbetet rrugë tjetër veçse të mbështetet tek mëshira e Zotit.

Nga ana tjetër duhet të kemi kujdes që të kuptojmë se ne nuk mund të bëjmë gabime gjatë gjithë kohës duke menduar se gjithsesi Allahu do të na falë...

Në Kuranin Famëlartë thuhet :

"Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t'ju mashtrojë për Allahun." (Lukman, 33)

Zoti ynë është falës, Ai e do faljen. Duhet ta dimë këtë gjë, duhet ta ndjejmë; por nuk ka kuptim që të bëjmë gabime gjatë gjithë kohës duke shpresuar vetëm tek falja e të Mëshirshmit. Mos të harrojmë se shejtani ka rënë në këtë gjendje të keqe në të cilën ndodhet sot vetëm si shkak i kryelartësisë që tregoi.

Në Kuran kjo ngjarje tregohet kështu:

"Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë. Nuk i pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: "Unë tani metë vërtetë po pendohem". As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm." (Nisa, 17-18)

Duhet të kemi parasysh dhe diçka tjetër: nuk ka mëkat të vogël dhe mëkat të madh. Më e rëndësishme është fakti se ndaj kujt bëhet ky mëkat. Nganjëherë, Allahu e fal robin e vet edhe kur ky bën një të mirë që në dukje është e vogël; por nganjëherë e dënon një tjetër për një gabim që mund të mos duket shumë i rëndë.

Allahu është së bashku me njerëzit që janë në nevojë, Ai nuk është me njerëzit krenarë...

Besimtari duhet të qëndrojë larg mëkateve dhe çdo fjale e cila ka rrezik që ta afrojë me mëkatet dhe rrugën e gabuar. Ashtu siç ruhemi nga një helm i rrezikshëm për të mos u sëmur ose për të mos vdekur ashtu duhet të ruhemi nga mëkatet, të cilat e sëmurin dhe e vrasin shpirtin tonë. Rebelimi gjithashtu e vret zemrën tonë dhe e dëmton moralin e pastër. Për një besimtar zemra është organi më i rëndësishëm i trupit të tij. Kur zemra fillon të bëjë gabime i gjithë trupi e pëson. Mëkatet në fillim sulmojnë zemrën, ato mundohen ta ndotin atë dhe ta ngurtësojnë. Një zemër e cila është e ndotur nga mëkatet fillon që të mos marrë kënaqësi nga kryerja e adhurimeve, ky është ndëshkimi i parë që ajo merr. Ndëshkimi i dytë që ajo merr është humbja e ndjenjës së mëshirës dhe dhembshurisë. Në këtë mënyrë ajo humbet paqen e vet. Ndëshkimi i tretë është rreziku i mosmbrojtjes së besimit të vet në çastin e vdekjes.

Allahu i largoftë gjynahet nga ne. Në momentin kur bëjmë gabim na e mundësoftë pendimin sa më shpejt që të jetë e mundur. Mos qofshim ne nga njerëzit që nuk kanë fatin të pendohen para se Azraili të vijë e t'ju marrë shpirtin!.. Amin.



Fatma Nur Xhiban

Ramazani
muaji i adhurimit

A i keni parasysh sitat që përdoren për të pastruar miellin... Ose ato që përdoren për të pastruar elementet e ndryshme... Ramazani i ngjan pikërisht këtyre sitave...

Ramazani e pastron njeriun nga gjërat e dëmshme dhe të tepërta. Me anë të Ramazanit njeriu pastrohet nga mëkatet, bëhet më i ndjeshëm dhe më i pastër. Ramazani na pastron neve nga mëkatet tona, nga veset e këqija dhe pastaj largohet. Ne largohemi nga ai, dhe ai largohet nga ne...

Ramazani është stina e agjërimit... Për gjatë një muaji të gjithë myslimanët (të cilët i plotësojnë kushtet e duhura) agjërojnë. Të gjithë gratë dhe burrat që kanë arritur moshën e pjekurisë e kanë për detyrim që të agjërojnë. Nga kjo kuptojmë që secili prej nesh fiton diçka nga agjërimi. Mendoni për fëmijën e vogël që nuk ha një prej vakteve të ditës. Sigurisht që ne mërzitemi për të dhe mundohemi që ta marrim me të mirë, t'i gatuajmë ushqimet e tij të preferuara. Ky shqetësim lind nga fakti që jemi prindër dhe kemi mëshirë për fëmijët tonë. Po Zoti ynë, pse kërkon që të agjërojmë për një kohë aq të gjatë? Ai është më i Mëshirshmi... Do të thotë se agjërimi është i dobishëm për ne, ai është për të mirën tonë... Allahu nuk ka nevojë për gjërat që bëjmë ne, çdo gjë që e bëjmë është për të mirën tonë...

"Çfarë të mire mund të na sjellë uria?"... Përgjigjen e kësaj pyetjeje po e lë në dorë të doktorëve dhe personave që merren me studimin e dietave, ne le të merremi me

anën shpirtërore të agjërimit.

Njeriu i uritur e kupton më mirë gjendjen e njerëzve të tjerë të uritur. Ai mendon për gjendjen e njerëzve që kalojnë kohë shumë të gjatë të uritur. Ne agjërojmë me vetëdije, kjo na bën që të jemi më të mëshirshëm ndaj njerëzve që janë të uritur. Njeriu që agjëron kohën që zakonisht ia dedikon ushqimit, në Ramazan merret me gjëra më të dobishme. Mendimet e njeriut që është agjërueshëm thellohen, trupi qetësohet, zemra pastrohet.

Pejgamberi ynë na ka thënë se shpërblimi i agjërimit nuk është i përcaktuar. Zoti ka thënë se do ta shpërblejë robin e Tij ashtu siç ai e meriton. Shpërblimi për çdo njeri do të jetë i ndryshëm në varësi të vështirësive të kaluara dhe përkushtimit me të cilin ka agjëruar. Allahu na bëftë prej njerëzve që do të shpërblehen për agjërimet e tyre. Amin.

Agjërimi nuk është adhurimi i vetëm i Ramazanit.

Ramazani është muaji i Kuranit. Në çdo muaj Ramazani Pejgamberi ynë i nderuar me engjëllin Xhebrail lexonte ajetet që ishin zbritur deri atëherë. Nga kjo kuptojmë se Ramazani është muaji në të cilën duhet lexuar Kurani, duhen përsëritur suret që dimë përmendësh dhe të mësojmë të tjera të reja... Mos të lexojmë vetëm në arabisht por të lexojmë edhe kuptimin e sureve dhe të mundohemi që t'i praktikojmë në jetën tonë mësimet e marra!..

Ramazani është muaji i dhuratave... Ai është muaji në të cilën gëzohet i varfëri dhe i pasuri. I varfëri merr ndihma që ia lehtësojnë jetën kurse i pasuri kryen një detyrim të fesë.

Ramazani është muaji i namazit... Namazet e natës, namazet e sabahut të falur me xhemat, pesë vaktet e namazit të cilat mundohemi me sa kemi mundësi që t'i falim në xhami... Namazet nafile... Ditë dhe net të kaluara në xhami...

Ramazani është muaji i familjes... Ai është muaji ku forcohen lidhjet familjare dhe vizitohen të afërmit që ndoshta i kemi lënë pas dore... Ai është muaji në të cilën njerëzit kujdesen më shumë për njeri-tjetrin...

Ramazani është muaji i umres... Është rasti për të hequr mallin e Qabes, Mekes dhe Medines... Sa të begata janë namazet, agjërimet, adhurimet e bëra në këto toka të shenjta...

Ramazani është muaji gjatë të cilit lidhen shejtanët, egoja shtypet, zemrat fluturojnë, njerëzit bëhen më të mirë, çdo vend mbushet me mëshirë hyjnore...

Në Ramazan gjendet edhe ajo që është më e mirë se një mijë net, nata e Kadrit... Njeriu i cili arrin të përfitojë si duhet nga ajo natë është sikur të kishte bërë adhurime gjatë gjithë jetës.

Një muaj kaq i begatë... Sa keq për njerëzit të cilët nuk arrijnë që të përfitojnë nga të mirat dhe përparësitë e këtij muaji... sa keq për ato njerëz të cilët nuk arrijnë dot të përfitojnë nga mëshira e këtij muaji!.. Kush mund ta di nëse do të arrij të shikoj apo jo Ramazanin e vitit të ardhshëm...

Ndoshta ky Ramazan do të jetë Ramazani ynë i fundit!.. Ndoshta nuk do të kemi më rastin të pastrohemi prej mëkateve në këtë mënyrë!... Le të përfitojmë prej këtij Ramazani. Le t'i rregullojmë gjërat që kemi thyer, le të lehtësojmë aty ku kemi mundësi. Le ta mbushim zemrën tonë me gjëra të cila do të jenë të dobishme për botën tjetër. Të gjitha të mirat materiale që zotërojmë le t'i kthejmë në mirësi morale të cilat do të na ndihmojnë në ditën kur do të dalim përpara llogarisë. Le t'i japim përjetësi virtyteve. Le të bëhemi nga ato të cilët e shesin këtë botë për të blerë Ahiretin.

Gjatë gjithë këtij muaji engjëjt luten me përgjërim: A nuk ka ndonjë njeri që kërkon diçka nga Zoti i vet që ne t'ia japim!.. A nuk ka ndonjë njeri që kërkon shërim nga Allahu dhe ne t'ia japim!.. A nuk ka ndonjë që kërkon falje nga Allahu dhe ne t'ia japim!.. A nuk ka? A nuk ka?!..

Mos t'i humbasim të mirat e këtij muaji kaq të begatë! Mos ta kalojmë muajin e bekuar të Ramazanit ashtu siç i kalojmë ditët e tjera të jetës sonë! Le të marrë Ramazani të gjitha mëkatet tona! Le të dalim nga Ramazani të pastruar dhe me moral të lartësuar!

Le t'i dorëzohemi Ramazanit. Më besoni, në fund të muajit do të jeni një njeri krejtësisht i ndryshuar. Ju vetëm kryeni detyrat tuaja ndaj këtij muaji të bekuar.

Seher Ajdën

SHKALLËT E EDUKIMIT GJATË RAMAZANIT

Adhurimet që bëjmë gjatë jetës sonë janë edukim për ne. Ashtu siç shkojmë pranë një mjeshtri për të mësuar zanatin dhe punojmë me vite të tëra për të arritur në vendin e dëshiruar; ashtu duhet të edukohemi dhe të zbukurohemi me moral të lartë para se të shkojmë në xhenet.

Ramazani është një nga mënyrat më të mira për të fituar këtë edukim. Me anë të agjërimit nuk edukohet vetëm zemra por edhe shumë organe të tjera duke qenë se qëndrojmë pa ngrënë dhe pa pirë.

Ja se çfarë ka thënë Pejgamberi ynë i dashur për agjërimin:

"Për Allahun nuk ka asnjë adhurim tjetër më me vlerë (nga i cili fitohen më shumë sevape)." (Nesei, Sijam, 43)

"Atë që agjërimi e largon nga ushqimet dhe pijet që i pëlqejnë, Allahu do e ushqejë me frutat e xhenetit dhe do i jap të pijë nga lumenjtë e xhenetit." (Kenzul Ummal, II, 328)

"Kush agjëron dhe e siguron fitimin e vet nga hallalli nuk do të merret në llogari në Ahiret." (Kenzul Ummal, III, 328)

Duhet të kemi parasysh që agjërimi nuk ka të bëjë vetëm me lënien bosh të stomakut por edhe me shumë gjëra të tjera; kontrollin e gjuhës, dhe nënshtrimin e disa ndjenjave si inati, zilia, keqdashja . Në Ramazan ne agjërojmë me të gjithë organet tona, për hir të Allahut. Agjërimi ka një të mirë shumë të madhe sepse kur stomaku është bosh është më kollaj të edukosh organet e tjera. Të gjithë e kemi vënë re se në Ramazan numri i krimeve bie dhe rritet toleranca mes njerëzve.

Mësimi i parë i agjërimit është të mosngrënit me tepri. Pejgamberi ynë (a.s) dhe të gjithë sahabët e nderuar hanin pak. Njerëzit e ditur na kanë mësuar se stomaku i ngjan një kazani që zien poshtë zemrës sonë. Kur kazani zien avulli i tij shkon drejt zemrës dhe e shqetëson atë, e nxin zemrën. Ja se çfarë ka thënë Pejgamberi (a.s.) për ngrënien e tepërt:

"Problemi i parë që do t'i lind umetit pas vdekjes së pejgamberëve është ngrënia e tepërt dhe ambicia e tepruar. Sepse kur stomaku i një populli ngopet forcohen trupat e tyre, dobësohen zemrat dhe rriten ndjenjat erotike." (et-Tergib vet Terhib, IV, 367)

"Drita e dijes është mos ngrënia e tepërt. Gjëja më e rëndësishme e fesë është heqja dorë nga kjo botë. Mënyra për t'iu afruar Allahut është duke iu afruar njerëzve në nevojë. Mënyra për t'u larguar nga Allahu është mos ngopja me mëkate. Mos e mbushni më shumë se duhet stomakun tuaj sepse do t'ju fiket drita e zemrës suaj..." (Kenzul Ummal 4/472)

Një nga mënyrat më efikase për të shpëtuar nga ngrënia

e tepërt është agjërimi, por duhet të kemi kujdes që të mos e teprojmë në iftar dhe në syfyr. Duhet të kemi kujdes që sofrat tona të iftarit dhe syfyrit të mos ngjasojnë me sofrat e faraonit. Nuk duhet të harrojmë se rregulli: pak ushqim, nuk është i vlefshëm vetëm në disa kohë të caktuara. Ky rregull duhet ndjekur gjithmonë; në kohë urie dhe në kohë bollëku, në udhëtim dhe në shtëpi, në syfyr dhe në iftar. Hasan Basri (r.a) na ka kështilluar:

"Agjëroni por mos e teproni!"

Kur e pyetën atë:

"- Çfarë nënkupton me teprim?"

Ai iu përgjigj:

"Teprim është kur një njeri thotë: Nesër do të agjëroj, përgatitni për mua këtë, atë."

Imam Gazaliu i ka radhitur kështu rreziqet e ngrënies së tepërt:

1- Verbërohet largpamësia.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Mos i vrisni zemrat tuaja duke ngrënë shumë. Zemra vdes nga ngrënia dhe pirja e tepërt ashtu siç vdes fidani nga ujitja e tepërt." (Siraxhut- Talibin, I, 485)

2- Pakësimi i adhurimit

Jahja (a.s.), takohet me Iblisin. Kur shikon disa çengela në duart e tij e pyet:

"- Çfarë janë ato?"

Iblisi i përgjigjet:

"-Këto janë epshet, unë i gjuaj njerëzit me këto dhe i bëj që të devijojnë nga rruga e drejtë!"

"– A ke ndonjë gjë me të cilën mund të më gjuash mua?"- e pyet.

"- Jo,nuk kam, por ti një natë e mbushe shumë stomakun dhe ne ta vështirësuam faljen e namazit!"-iu përgjigj Iblisi.

Pas kësaj Jahja (a.s.), i tha:

"- Atëherë unë nuk do të ha më kurrë më shumë se sa kam nevojë!.."

3- Dobësimi i intelektit dhe zgjuarsisë

Ebu Sulejman ed- Darani ka thënë:

"Nëse ke ndonjë dëshirë në lidhje me këtë botë ose me botën tjetër qëndro pa ngrënë deri kur kjo dua të realizohet sepse ngrënia e tepërt është e dëmshme për mendjen."

4- Hapja e ngatërresave dhe kalimi i kohës me punë të pa dobishme

Ebu Xhafer (r.a) ka thënë:

"Stomaku është një organ i tillë që nëse ai është i uritur të gjitha organet tjera janë të ngopura, pra të gjitha organet janë të qeta dhe nuk të kërkojnë asgjë. Kur stomaku është i ngopur të gjitha organet e tjera janë të uritura."

5- Humbja e dëshirës për adhurim

Ebu Bekri e tregon kështu sekretin e besimit të vet:

"Qëkur jam bërë mysliman nuk kam ngrënë asnjëherë për t'u ngopur sepse në këtë mënyrë arrihet fitimi i dëshirës për adhurim. Qëkur jam bërë mysliman nuk kam pirë asnjëherë për t'u ngopur nga dëshira që kisha për t'u takuar me Zotin tim!.."

6- Rreziku i haramit dhe i gjërave të dyshuara

Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), ka thënë:

"Fillimi i diturisë është frika ndaj Allahut. Ruajtja nga veprimet e dyshimta është më fisnikja e punëve." (Ebu Nuajim, Hiljetul Evlija, II, 387)

7- Zënia e zemrës dhe trupit me gjëra të panevojshme

Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), ka thënë:

"Fillimi i të gjitha sëmundjeve është ngrënia e tepërt sepse prej saj trupi rëndohet; fillimi i të gjitha shërimeve është ngrënia pak, periza." (Sujuti, I, 140)

8- Vështirësi në momentin e vdekjes dhe në ahiret

Ebu Xhuhafe (r.a) tregon:

"Një ditë hëngra një ushqim të bërë nga mishi dhe buka pastaj shkova pranë Pejgamberit tonë të nderuar, pa dashur gogësiva.

Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), më tha:

- O Ebu Xhuhafe! Mbaje gogësimën larg nesh. Ato njerëz që ngopen shumë në këtë botë do të qëndrojnë të uritur në botën tjetër." (Tirmidhi, 2478)

9- Pakësimi i sevapeve

Sevapet e njerëzve që hanë shumë në këtë botë pakësohen. Allahu (xh.sh) ka thënë:

***"Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit** (do t'u thuhet) **: 'Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur Allahut.'"* (Ahkaf,20)

Një ditë Omerin (r.a) e merr etja shumë dhe kërkon ujë për të pirë. Dikush i jep ujë në një enë të bërë nga lëkura e pemës së hurmës. Omeri (r.a) e afron ujin pranë vetes por vë re se uji është shumë i ëmbël dhe i ftohtë, i drejtohet njeriut që i dha ujin me fjalët:

"- Merre këtë!.."

"– Uroj që të mos kem bërë gabim duke të ofruar ujin më të ëmbël për të pirë !.." – i drejtohet burri.

Hazreti Omer (r.a) i thotë:

"- Pikërisht kjo më ndaloi. Sikur të mos isha i shqetësuar për botën tjetër edhe unë do të jetoja si ju!.."

10- Marrja në llogari në Ditën e Gjykimit

Ja se çfarë ka thënë Pejgamberi (a.s.), në lidhje me njerëzit që janë shumë të dhënë pas kësaj bote:

"Për gjërat e hallallit që keni zotëruar në botë do të merreni në llogari, për gjërat e ndaluara do të ndëshkoheni!.." (Ihja, II, 220)

Melike Shabin

Agjërimi

Në arabisht fjala saum (agjërim) ka kuptimin: ndalem, pushoj, përmbahem, agjëroj.

Ndërsa në legjislacionin islam, agjërimi është detyrë e domosdoshme fetare për çdo mysliman dhe myslimane të moshës madhore dhe të mençur, që të heqë dorë nga ushqimi, pija, marrëdhëniet intime, duhani dhe veprimet e ngjashme që e prishin agjërimin dhe që nga agimi deri në perëndim të diellit, me nijet që këtë ta bëjë në emër të Allahut, nëse për këtë nuk ka pengesa.

Koha e agjërimit

Agjërimi mbahet që nga koha e zbardhjes së ditës në mëngjes deri në kohën e fillimit të mbrëmjes; pra nga imsaku gjer në aksham. Akshami është koha kur dielli prek horizontin. Në këtë moment bëhet iftar dhe prishet agjërimi.

Agjërimi ka qenë detyrim edhe për popujt para nesh

Kuran na mëson se agjërimi ka qenë obligim edhe për popujt që kanë jetuar para nesh:

"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini. (Bekare, 182-183)

Agjërimi është një adhurim shumë i dobishëm

Agjërimi është një nga kushtet e Islamit. Të gjithë myslimanët pranojnë faktin se agjërimi gjatë muajit të Ramazanit është i detyrueshëm.

Le të kujtojmë disa nga hadithet e Pejgamberit tonë të nderuar që kanë lidhje me agjërimin:

"Kur vjen muaji i Ramazanit hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe shejtanët lidhen me zinxhirë." (Myslim, Sijam,1-2)

"Për çdo vepër të mirë që bëjmë marrim një shpërblim prej dhjetë deri në shtatëqind fish, por agjërimi është jashtë këtij rregulli, sepse agjërimi është për Mua dhe shpërblimin e tij do ta jap Unë."

"Kush nga ju beson dhe agjëron duke shpresuar në faljen e Allahut (xh.sh), atij do t'i falen të gjitha mëkatet e të kaluarës." (Buhari, Savm, 6)

"Për njeriun që agjëron ka dy momente gëzimi. I pari është momenti kur bën iftar, kurse i dyti është kur bashkohet me Allahun!.." (Buhari, Savm, 9)

"Agjërimi është gjysma e durimit." (Tirmidhiu, Deavat, 86)

"Njerëzit që kanë agjëruar do të futen nga dera "Rejjan" e cila është caktuar vetëm për agjëruesit." (Nesai, Sijam, 43; Musned, V, 225)

"Agjëroni dhe do të gjeni shpëtim!.." (Ebu Nuajm, Kitabutt- Tib, Ebu Hurejre)

"O ju të rinj!.. Kush ka mundësi le të martohet sepse martesa e ruan syrin dhe dëlirësinë nga harami. Ato që nuk mund të martohen le të agjërojnë sepse agjërimi është një mburojë mbrojtëse." (Buhari, Savm, 10; Ebu Davud, Nikah, 1; Nesai, Sijam, 43)

Në hadithin kudsi thuhet:

"Për çdo vepër të mirë që bëjmë marrim një shpërblim prej dhjetë deri në shtatëqind fish por agjërimi është jashtë këtij rregulli, sepse agjërimi është për Mua dhe shpërblimin e tij do ta jap Unë." (Buhari, Savm,1,9; Muslim, Sijam,30; Nesai, Sijam,42)

Llojet e agjërimit

Agjërimi i muajit të Ramazanit është farz (obligim). Njerëzit të cilët nuk mund të agjërojnë gjatë Ramazanit duhet t'i zëvendësojnë këto dito; gjithashtu edhe kefareti (shpagesa që duhet bërë kur prishet me dashje agjërimi) është farz.

Agjërimet që nuk janë të përfshira tek agjërimet farz dhe vaxhip quhen nafile. Agjërimet nafile mund të mbahen në ditët që janë të lejuara për agjërim, por ka disa ditë të cilat Pejgamberi jonë i ka këshilluar si të dobishme për agjërim. Disa nga këto janë: agjërimi që ka ndjekur Davudi (a.s.), i cili një ditë e kalonte me agjërim ditën tjetër jo dhe kështu me radhë, agjërimin e ditës se 13,14 dhe 15-të të çdo muaji hënor, agjërimin në ditët e hëne dhe të enjte të çdo jave, agjërimi gjatë gjashtë ditëve të muajit Shevval, agjërimi i ditës së Arefes, agjërimi në nëntë ditët e para të muajit Dhulhixhxhe, agjërimi i ashures

(ditët e 9, 10 dhe 11 të muajit Muharrem), agjërimi në ditët e muajve Rexhep dhe Shaban .

Dita e parë e Bajramit të Ramazanit dhe katër ditët e Kurban Bajramit janë mekruh sepse këto janë ditët që duhet bërë festë. Ai që agjëron këto ditë bën mëkat dhe nuk fiton asnjë sevap nga agjërimi që ka bërë.

Mekruh është edhe agjërimi i ditës së ashures pa agjëruar edhe një nga ditët e nëntë ose të njëmbëdhjetë të muajit Muharrem. Agjërimi vetëm i ditës së premte ose të shtunë pa i bashkuar me ditën paraardhëse ose pasardhëse është mekruh. Agjërimi i ditës së fundit të muajit Shaban kur nuk dallohet dot nëse është dita e fundit e këtij muaji apo e para e Ramazanit është gjithashtu mekruh (kjo gjë bëhet nga frika se mos kjo ditë mund t'i shtohet gabimisht ditëve të Ramazanit).

Për kë është detyrim agjërimi?

Agjërimi është farz për njeriun që është mysliman, pa probleme mendore, i pjekur dhe ka mundësi për të agjëruar (për shembull nuk është udhëtar).

Njerëzit që mund ta prishin agjërimin që kanë filluar të mbajnë janë këto:

1- Udhëtari: Në qoftë se ka mundësi është më e pëlqyer që të agjërojë.

2- I sëmuri: Një i sëmurë mund ta prishë agjërimin e vet kur ka frikë nga vdekja, përkeqësimi i sëmundjes, zgjatja e sëmundjes ose nga lindja e problemeve mendore. Këshillohet konsulta me një doktor mysliman për të kuptuar a është i rrezikshëm agjërimi për sëmundjen. Të sëmurët që nuk kanë shpresë shërimi dhe që nuk do të kenë më mundësi që të agjërojnë, ashtu si pleqtë nuk agjërojnë dhe nuk kanë nevojë që t'i zëvendësojnë këto dito, këto njerëz i japin të varfërve lëmoshë çdo ditë.

3- Gratë shtatzëna ose ato që ushqejnë fëmijët me qumësht,

4- Të moshuarit: Njerëzit e moshuar të cilët kanë vështirësi për të agjëruar janë të lirë për të mos agjëruar. Këto nuk kanë nevojë as të zëvendësojnë ditët që kanë lënë pa agjëruar, por në vend të kësaj japin lëmoshë (fidje) një të varfëri.

5- Njeriu që lufton me armikun,

6- Prishja e agjërimit nën presion: Në qoftë se dikujt i kërcënohet jeta ose ndonjë gjymtyrë e trupit mund ta prishë agjërimin dhe ta zëvendësojë më vonë këtë.

7- Gratë me menstruacione dhe në kohën e lehonës,

8- Etja dhe uria e padurueshme: Njeriu që ka frikë se uria ose etja e madhe do t'i krijoj shqetësime serioze mund ta prishë agjërimin për ta zëvendësuar atë një ditë tjetër.

Fidja e agjërimit

Njerëzit të cilët janë shumë të sëmurë ose të moshuar kanë të drejtë që të mos agjërojnë dhe në vend të kësaj japin fidje. Fidje do të thotë të sigurosh ushqimin e një të varfëri për një ditë (2 vakte: mëngjesin dhe darkën).

Fidja e Ramazanit mund të jepet në fillim ose në fund të tij. Fidja e tridhjetë ditëve të Ramazanit mund t'i jepet vetëm një personi ose disa njerëzve të ndryshëm. Është e lejuar që fidja të jepet edhe në formë parash.

Në rastin kur njeriu i sëmurë apo i moshuar përmirësohet në mënyrë që mund të agjëroj rregulli i fidjes bie poshtë dhe personi i agjëron ditët që duhet t'i zëvendësoj.

Çfarë kushtesh duhet të plotësojë agjërimi për t'u pranuar

Për t'u pranuar agjërimi duhen plotësuar tre kushte. Të mos gjendet në kohën e menstruacionit ose lehonës, të bërit nijet (qëllimi) dhe qëndrimi larg gjërave që e prishin agjërimin.

Agjërimi i gruas që është me menstruacione ose në kohën e lehonës nuk pranohet. Kjo grua i zëvendëson ditët që nuk ka agjëruar. Për të vazhduar agjërimin gruaja duhet të pastrohet nga gjendja e xhunubit. Është e pëlqyeshme që pastrimi të bëhet përpara akshamit ose syfyrit.

Të bësh nijet me zemër është e pranueshme. Një njeri i cili që në mbrëmje mendon se të nesërmen do të agjërojë ose që ngrihet në syfyr me atë qëllim llogaritet sikur ka bërë nijetin. Ky është nijeti që bëhet me zemër por është më e pëlqyeshme të bëhet edhe me fjalë.

Veprime të pëlqyera

1- Ngrënia e syfyrit,

2- Përgatitja e sofrës së iftarit para kohës së akshamit,

3- Prishja e agjërimit duke bërë dua,

4- Të ftosh njerëz të tjerë për iftar

5- Marrja e gusulit në mëngjes, para hyrjes së namazit të sabahut,

6- Ruajtja e gjuhës nga gjërat e padobishme,

7- Leximi i Kuranit gjatë muajit të Ramazanit, bërja e duave gjatë gjithë kohës, përpjekja për të plotësuar dijet fetare, kalimi i ditës duke plotësuar adhurimet që i kemi lënë kaza.

8- Veçanërisht në dhjetë ditët e Ramazanit tërheqja në itikaf.

Mekruhet e Ramazanit

1- Përtypja e diçkaje pa pasur një shkak. Nëse gjëja që je duke përtypur kalon në grykë agjërimi prishet.

2- Përtypja e çamçakëzit që ke pasur edhe para agjërimit në gojë (bëhet fjalë për çamçakëzat që nuk kanë sheqer, të bardhë dhe që nuk ndahen). Përtypja e çamçakëzit i cili ka sheqer dhe shije e prish agjërimin.

3- Puthja dhe përqafimi me gruan/ burrin është mekruh sepse ky veprim mund ta çojë njeriun në një gjendje në të cilën i prishet agjërimi.

4- Marrja e gjakut nga damarët është mekruh sepse kjo gjë e lodh trupin e njeriut.

5- Pastrimi i dhëmbëve me misvak pasi i lag ato me ujë është mekruh. Larja me misvak të thatë nuk paraqet asnjë problem.

6- Lagia me ujë e gojës apo hundës me qëllimin për t'u freskuar është mekruh.

Gjërat që nuk e prishin agjërimin

Ngrënia, pirja ose kontakti seksual që bëhet pa dashje nuk e prish agjërimin.

Njerëzit që hanë diçka pa dashje nuk e prishin agjërimin, por vazhdojnë ta mbajnë atë. Pejgamberi ynë njerëzve që u ndodhte diçka e tillë u ka kujtuar se kjo është një dhuratë që Allahu u bën atyre.

Gjërat që e prishin agjërimin dhe na detyrojnë neve që ta zëvendësojmë atë

1- Përtypja ose ngrënia e gjërave të cilat normalisht nuk na ushqejnë. Për shembull: brumi i pa bërë, mielli, lëkura e frutave të thata, xhami apo dërrasa.

Vjedhja nuk e prish agjërimin në qoftë se nuk bëhet me qëllim. Në rastin kur bëhet me qëllim, agjërimi prishet kur vjedhja bëhet me gojë plot.

Kur ndodh gjakosje e dhëmbëve, kalimi nëpërmjet fytit i një sasie të konsiderueshme e gjakut e prish agjërimin kurse një sasi e vogël nuk e prish atë.

Ilaçet që hidhen në vesh ose në hundë e prishin agjërimin sepse këto ilaçe me anë të fytit kalojnë në stomak; kurse uji që futet/bie në vesh nuk e

prish agjërimin.

2- Marrja e një ilaçi për arsye shëndetësore na detyron që ta zëvendësojmë atë ditë të agjërimit.

Shkaqe të tjera të cilat na detyrojnë që të zëvendësojmë ditën e agjërimit janë : sëmundja, udhëtimi, detyrimi, gabimi, dyshimi. Të gjithë këto gjëra nuk kërkojnë shpagim por vetëm zëvendësim.

3- Joshja e cila nuk çon në bashkim seksual nuk kërkon shpagim por zëvendësimin e ditës së agjërimit.

Gjërat që kërkojnë edhe shpagim edhe zëvendësim,

1- Ngrënia e produkteve ushqimore, ngrënia ose pirja e tyre pa një arsye,

2- Kryerja e marrëdhënieve seksuale kur je agjërueshëm,

Shpagimi i agjërimit zbatohet vetëm në rastet kur bëhet fjalë për agjërimet e detyrueshme të cilat fillojnë më bërjen e nijetit, pra agjërimin gjatë Ramazanit. Për të gjitha llojet e tjera të agjërimeve ekziston rregulli: "një ditë për një ditë" ; por edhe për këto agjërime të cilat fillohen dhe lihen përgjysmë është e kështillueshme që të kërkohet falje nga Allahu (xh.sh).

Ka tre mënyra për të plotësuar shpagimin:

1- Dhënia e lirisë një të robëruari.

2- Agjërimi për dy muaj rresht.

3- Dhënia e ushqimit gjashtëdhjetë njerëzve të varfër.

Këto veprime bëhen sipas radhës në të cilën janë shpjeguar. Ndjekja e kësaj radhe është kështilluar edhe me hadithet e Pejgamberit tonë të nderuar.

Agjërimi për shpagim mbahet për dy muaj me radhë dhe pa bërë pushim. Në qoftë se në këto gjashtëdhjetë ditë agjërimi prishet për një ditë kjo e fundit i shtohet agjërimit; pra do të agjërohet për gjashtëdhjetë e një ditë. Në qoftë se brenda një Ramazani agjërimi prishe për dy-tre ditë një shpagim është i mjaftueshëm. Numri i ditëve që është prishur Ramazanit i shtohet ditëve të shpagimit.

Rëndësia që i jepet shpagimit të ditëve që nuk agjërohen gjatë Ramazanit na tregon rëndësinë që ka ky muaj i bekuar. Prishja e agjërimit me arsye nuk detyron shpagim, vetëm zëvendësimin e ditës së agjërimit. Njerëzit të cilët nuk mund ta plotësojnë shpagimin çlirohen nga ky detyrim. Çdo njeri e paguan shpagimin në mënyrën që ka mundësi.

Njerëzit që pa pasur asnjë arsye nuk agjërojnë Ramazanin

Njeriu i cili pa pasur asnjë arsye nuk agjëron është mëkatar sepse Resulallahu (a.s.), ka thënë:

"Njeriu i cili e lë agjërimin e një dite të Ramazanit pa arsye (kur nuk ka as arsye sëmundjet) edhe nëse agjëron gjatë të gjitha ditëve të tjera të jetës së tij nuk arrin që ta shlyej krejtësisht borxhin e asaj dite." (Ibn Maxhe, Sijam, 14; Darimi, Savm, 18)

Sipas Hanefive dhe Malikive ashtu siç bëhet zëvendësimi i ditëve të Ramazanit ashtu duhet bërë zëvendësimi edhe i agjërimeve të tjera.

Zëvendësimi i ditëve të Ramazanit nuk ka pse të bëhet me ngut apo njëra pas tjetrës. Personi mund të agjëroj sipas dëshirës, mund të agjëroj të gjitha ditët njëra pas tjetrës ose në ditë të ndryshme.

Terapia

që vjen nga qielli

Fatma Alladag

Shumica prej nesh ngaqë nuk jemi të kënaqur me ushqimet që marrim shëtisim nga një doktor tek tjetri... Jemi dakord që të paguajmë çdo shumë të nevojshme për të marrë rezultatet e kërkuara.

Ne jemi njerëz, nuk mund ta kuptojmë se për çfarë ka nevojë shpirti ynë. Ne e mbushim stomakun vetëm për kënaqësinë tonë... Presim që në kuzhinën tonë të vijnë psikologët. Mbyllim sytë dhe hapim veshët për të regjistruar sa më mirë recetën që na jepet. Në këtë mënyrë kalojnë muajt dhe papritur dëgjojmë zhurmën e daulleve, zgjohemi për syfyr...

Ramazani është një terapi që vjen nga qielli... Ai është mënyra më e shëndetshme e urisë. Nuk di se nga cila e mirë e tij mund të filloj të flas; nga të mirat fizike, psikologjike apo nga sevapet që fitojmë prej tij. Agjërimi është një adhurim që na siguron një fitim të madh për në botën tjetër...

Në vitin 1877, në Amerikë Dr. Edward Dyun filloi një studim në lidhje me të mirat e agjërimit. Në librin me temë : "Terapia me anë të agjërimit" ai ka shkruar:

"Ky libër është shkruar me anë të përvojave jetësore të një doktori i cili ka kërkuar shërim me anë të ilaçeve. Pasi u binda se të gjitha ilaçet ishin jo efektive në shërim unë provova agjërimin dhe mund të them me siguri të plotë se agjërimi është një mënyrë për të luftuar të gjitha sëmundjet që mund të kalojë një njeri."

Shkenca ka provuar se një njeri që agjëron e harxhon të gjithë energjinë e tij për të riprodhuar qelizat e veta, gjithashtu truri i këtij njeriu është më i ndërgjegjshëm dhe mban në gjendje pune të gjitha organet e tjera. Ndjenja e lodhjes që ndjejmë për një periudhë të caktuar nuk vjen nga uria por nga fakti se organizmi jonë fillon të bëjë një program të ri funksionimi. Vërtetimi i kësaj që thamë është rasti kur një njeri shumë i dobët e ruan kthjelltësinë e mendjes deri në ditën e vdekjes.

Për fëmijët agjërimi është një metodë e mirë që ndihmon zhvillimin e tyre. Agjërimi na mëson sesi t'i kontrollojmë veprimet tona, si t'i frenojmë reagimet e vrullshme pra ai ndihmon në krijimin e një karakteri të fortë dhe të qëndrueshëm. Agjërimi është i rëndësishëm sepse ai nuk forcohet nga ndikime të jashtme, ai është një adhurim që njeriu e kryen duke kontrolluar veten. Njeriu e di se ka mundësi për të ngrënë apo për të pirë diçka fshehurazi por nuk e bën këtë duke edukuar në këtë mënyrë egon e vet. Për më tepër në qoftë se njeriu i cili agjëron ka zakone si duhani, ai ia kujton vetvetes faktin se ka një vullnet të fortë.

Ne pastrojmë trupin tonë duke agjëruar, por në të njëjtën kohë, morali jonë forcohet dhe lartësohet... Njeriu që agjëron nuk qëndron vetëm larg ushqimit dhe pijes. Ai njeri qëndron edhe larg gabimeve morale sepse nuk dëshiron që agjërimi i tij të prishet. Njeriu që agjëron vepron duke dëgjuar zërin e ndërgjegjes. Njeriu që agjëron është shumë i kujdesshëm me veprimet e tij, sepse nuk dëshiron që të çojë dëm agjërimin e vet. Ai nuk do që të humbasin sevapet e tij prandaj i mendon mirë fjalët që thotë dhe i jep shumë rëndësi ndjenjave të njerëzve të tjerë. Ky është shkaku pse përqindja e krimeve ulet ndjeshëm gjatë Ramazanit. Në këtë mënyrë Ramazani bëhet një qetësi e veçantë që lind nga individi dhe mbulon të gjithë shoqërinë.

Mbetet vetëm një gjë...

Qetësinë shpirtërore që fitojmë me anë të agjërimit le ta ruajmë gjatë gjithë vitit, le ta përdorim atë në momentin kur jemi përballë problemeve në mënyrë që të mbushim enën tonë të sevapeve...

Kybra Çoban

Ramazani

në zemrën time prej fëmije

Të gjithë njerëzit ishin duke përjetuar një shqetësim të këndshëm. Të gjithë bënin përgatitje sikur do të vinin mysafirë. Ishte koha për të bërë pazar, për të pastruar shtëpinë... Çdo shtëpi është në të njëjtën gjendje. Nënat dhe baballarët mundohen që të blejnë të gjitha gjërat e nevojshme dhe të mos kenë më nevojë për të dalë gjatë këtyre ditëve të bekuara. Nënat tona bëjnë gati petat që do t'i gatuajnë në syfyr...

Çfarë do të thotë: "syfyr" ? Cilat ishin veçoritë e këtyre ditëve? Çfarë ndryshimi kishin prej ditëve tjera? Teksa unë po mendoja këto gjëra në dhomë hyri nëna ime me Kuran në dorë dhe më tha se do të shkonim në mukabele. Mendimet m'u trazuan. Gratë shkonin të gjitha në shtëpinë e një shoqes së mamasë time duke mbajtur Kuranin në dorë. Shkuam edhe ne. Unë bëja përpjekje për të kuptuar se çfarë po ndodhte. Gratë që zakonisht i mbanin flokët e lëshuara dhe të zbukuruara kishin vendosur shami në kokat e tyre, u shkonte shumë. Filluan të lexonin Kuran me zë të lartë. Sa bukur që lexonin. Çdo tingull më qetësonte shpirtin. Shtëpia ishte e mbushur me njerëz, sikur kishte ardhur e gjithë lagjja... Unë fillova të kisha nxehtë. Shikova nënën time, ajo po ndiqte me kujdes Kuranin. Unë desha t'i thosha diçka por ajo më bëri shenjë me gisht që të mos flisja. Atë ditë mësova se kur lexohet Kuran nuk duhet të flasim por të dëgjojmë me respekt.

Përgatitjet për Ramazanin vazhdonin. Në fakt unë u bëra shumë kureshtare, le të vijë ky Ramazani dhe të shikojmë se çfarë është... Nëna fliste me veten duke përmendur njerëzit të cilët ishte mirë t'i thërrisnim për iftar. Tashmë e kisha mësuar se çfarë ishte mukalebeje por ç'të ishte vallë iftari? Të gjithë ishin aq shumë të zënë sa nuk më jepnin asnjë përgjigje. Po prisja Ramazanin plot emocion pa e ditur arsyen .

Dita e shumëpritur erdhi. Babai kishte shkuar në xhami për të falur namaz. Ai gjithmonë shkonte në namaz, por këtë herë vonoi më shumë se herët e tjera.

E pyeta nënën:

"- Nënë, pse nuk erdhi babai akoma?"

"- Mos u shqetëso bij, ai sot do të fal edhe namazin e teravisë prandaj po vonohet."

Teravia? Nuk e kisha dëgjuar kurrë më përpara. Nuk durova dot më, e pyeta nënën time për secilën nga këto fjalë dhe ajo m'i shpjegoi gjatë e gjatë.

Mua më lindi një dëshirë e madhe për të agjëruar. Sa bukur është të qëndrosh pa ngrënë e pa pirë vetëm për hir të Allahut!... Mua më pëlqeu shumë kjo gjë. Unë e dua Zotin Tim!.. Unë dua të agjëroj për hir të Allahut!..

Në fillim nëna më kundërshtoi:

"- Ti je akoma e vogël, nuk mund të durosh dot!"

Kur e kuptoi se unë po këmbëngulja shumë në këtë dëshirë timen më dha leje të agjëroja vetëm nëse do të haja gjërat që ajo do të më thoshte. Sapo erdhi babai nga namazi i teravisë unë i dhashë lajmin e bukur. Ai më tha:

"- Shko menjëherë të flesh ose nuk do të të lejoj që të agjërosh!.."

Atë ditë unë kuptova se ngrënia në syfyr ishte shumë e rëndësishme. Dëshiroja të flija por nuk më linte emocioni. Nuk e kujtoj si më kishte zënë gjumi. Natën dëgjova zërin e nënës sime dhe u zgjova, lava fytyrën dhe u ula në tavolinë. Ushqimet e atij syfyri ishin ushqimet më të mira që kisha ngrënë ndonjëherë.

Në mëngjes hapa sytë për herë të parë me ndjesinë se isha agjërueshëm. Kisha shumë frikë se mos do të harroja dhe do ta prishja pa dashje agjërimin tim. Çdo ditë shkoja me nënën time për të dëgjuar leximin e Kuranit. Aq shumë isha mësuar sa nuk ndjeja më as nxehtë as lodhje. Ajetet e lexuara më qetësonin shpirtin. Ramazani i fëmijërisë sime qëlloi në kohën e ditëve të gjata të verës... Në iftar na vinin edhe familjarë të tjerë. Nëna më kishte mësuar se duatë e bëra në iftar pranoheshin gjithmonë. Unë bëja dua të gjata para se të prishja agjërimin.

Sofrat tona të thjeshta begatoheshin nga dashuria e miqve tonë. Ushqimet ishin më të mira se çdo herë tjetër. Në shtëpi mbizotëronte një atmosferë shumë e veçantë. Minutat tona ishin të mbushura me begati, dashuri dhe tolerancë. Zemrat tona u bënë më të ndjeshme. Duke qenë se ishim agjërueshëm ne e kuptonim më mirë gjendjen e njerëzve të varfër dhe në nevojë. Unë bëja dua për ta duke menduar që ne do të mbushim stomakun tonë sapo të këndonte ezani po ato çfarë do të bënin. Nganjëherë shkonim për iftar tek miqtë dhe të afërmit tonë. Teravitë, salavatet e thëna me zemër, ajetet e Kuranit... Gjatë atyre ditëve shqetësimi jonë më i madh ishte të ndihmonim njerëzit e varfër; të bënim të lumtur jetimët dhe ta shfrytëzonim sa më mirë këtë muaj me qëllimin për të fituar dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut...

Ditët kalonin dhe ne e ndjenim se edhe pak na ndante nga ndarja me këtë mik të mirë dhe të dashur. Babai im përsëriste këtë fjali: "Ky muaj i bekuar erdhi dhe po ikën, por vallë a ka qenë i kënaqur me ne?"

Si mund të kënaqej Ramazani vallë?

Ai është muaji i Kuranit, muaji në të cilin duhet ta kujtojmë sa më shumë Pejgamberin tonë të dashur, muaji në të cilën duhet të rritet toleranca mes njerëzve dhe të forcohen të gjitha ndjenjat e mira; ai është muaji në të cilin gjendet Nata e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj... A kemi fituar sa duhet nga ky muaj, a jemi gati për të pritur Bajramin? Nëse me sinqeritet të plotë i përgjigjemi pozitivisht këtyre pyetjeve atëherë mendoj se Ramazani ka mbetur i kënaqur nga ne. Sigurisht që përgjigjen e saktë të kësaj pyetjeje e di vetëm Allahu.

Ramazani është si një kandil që ndriçon në errësirë... Ai është një mundësi shpëtimi, është një rast i cili nuk duhet humbur. Ai është muaji i syfyrit dhe iftarit të thjeshtë. Ai na ndihmon të kuptojmë sa e mirë është era e bukës që vjen nga furra. Ai është muaji në të cilin ne arrijmë të kuptojmë vlerën e gjërave që zotërojmë dhe të mendojmë për gjendjen e njerëzve të cilët nuk i kanë këto gjëra. Ramazani është bollëk, dua, shpëtim. Në të njëjtën kohë është edhe shkatërrim për ato të cilët nuk kanë përfituar prej tij sepse Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Ai njeri nga umeti im i cili e arrin këtë muaj dhe nuk ia kushton çdo gjë Allahut le të pendohet menjëherë."

Ndërkohë që Zoti na jep një mundësi kaq të mirë për t'u pastruar nga mëkatet tona pse ta hedhim poshtë këtë të mirë dhe të tregohemi mosmirënjohës? Çdo çast i Ramazanit është shumë i çmuar. Duatë e bëra në syfyr, iftar, kur je duke lexuar Kuran nuk kthehen prapa. Bëji dua Zotit tënd që të të fal! Kërko me durim gjërat që dëshiron!.. Kur ti di si t'i lutesh Ai të jep çdo gjë...

Unë e fitova dashurinë për Ramazanin dhe mësova rëndësinë e bukurinë e tij që në moshën kur unë nuk e kisha detyrim të agjëroja... Po në ditët e sotme, sa ia ushqejmë fëmijëve tonë këtë gjë? A i mësojmë atyre gjërat të cilat duhet t'i dinë?

Unë nuk jam aq e vjetër, sa të them: "Ah si ishte Ramazani dikur!", por më ka marrë malli shumë për Ramazanet e viteve të kaluara!.. Për fat të keq Ramazani tashmë është aq i zbehtë sa nganjëherë e harrojmë fare se jemi në këtë muaj të bekuar. Mungojnë adhurimet dhe sjelljet që i kanë hije këtij muaji. Në fillim duhet të rregullojmë veten dhe pastaj le të përcjellim të mirën edhe tek njerëzit që na rrethojnë...

O Allah bëje Ramazanin një muaj shpëtimi dhe ringjalljet për ne! Amin!

Urtësi

Osman Nuri Topbash

NAMAZI
ELIKSIRI I MYSLIMANIT

Të gjithë krijesat në gjithësi: Dielli, Hëna, yjet, shkurret, barërat, pemët etj., janë gjithnjë në gjendjen e përkujtimit të Allahut të Madhëruar. Shpendët që fluturojnë tufa-tufa në qiell, malet e shkëmbinjtë i bëjnë ibadet Allahut përmes një tesbihati, të cilin ne nuk e njohim. Bimët bëjnë ibadet në këmbë (kijam); kafshët e bëjnë gjysmëpërkulur (ruku); kurse krijesat jofrymore e bëjnë ibadetin të puqura me tokën, pra në sexhde. Edhe gjendja e krijesave të qiejve është e tillë. Një pjesë e engjëjve bëjnë tesbih dhe tehlil në kijam, një pjesë në ruku dhe pjesa tjetër në sexhde.

Kurse namazi, që për besimtarët është ofruar si një miraxh, i përfshin të gjithë ibadetet. Ndaj dhe një besimtar, që fal namazin, duke kryer të gjithë ibadetet që bëjnë të gjitha krijesat që gjenden në qiej e në tokë, arrin të përfitojë shpërblime të pafundme dhe manifestime të thella shpirtërore.

Zoti i Madhëruar, e bëri njeriun më të përshtatshmin fizikisht në mesin i gjallesave, për t'i bërë sexhde Atij. Ndaj dhe mes namazit dhe njeriut ekziston një lidhje mjaft e fortë.

Namazi është koha e takimit me Allahun. Namazi i është dhuruar ymetit si një miraxh i vogël. Sipas urdhrit: ***"Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"***[1], begatia e të dalurit në audiencë të Zotit arrihet përmes namazit.

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Namazi është drita e syve të mi." (Nisai, Isharetun-Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199)

1. El-Alak, 19.

Namazi është shtyllë e fesë dhe dëshmuesi i Islamit. Me namazin nuk krahasohet asnjë ibadet.

Nga fisi Uzre patën ardhur tre vetë te Pejgamberi (a.s.), dhe qenë bërë myslimanë. I Dërguari i Allahut i pyeti:

- Kush do t'i mbajë si mysafirë këta?

Talha pati thënë:

- Unë, o Resulullah!

Kur po banonin tek Hazreti Talha, Resulullahu (a.s.), dërgoi një njësi ushtarake për ekspeditë. Njëri nga ata të tre u bë pjesë e kësaj njësie dhe ra shehid në luftë. I Dërguari i Allahut (a.s.), pas një periudhe kohore dërgoi një tjetër grup ushtarak për ekspeditë. Në të dytin ra shehid i dyti nga ata të tre. I treti, pas një periudhë kohe, ndërroi jetë në shtrat.

Talha (r.a.), tha:

"Këta tre persona që banuan tek unë, i pashë në ëndërr, në xhenet. Ai që vdiq në shtrat ishte më përpara se të tjerët. Ai që kishte vdekur i dyti vinte menjëherë pas tij, kurse ai që vdiq i pari ishte i treti. U habita dhe më erdhi keq që ai që vdiq në shtrat të ishte më i favorizuar sesa ata që ranë shehidë. Menjëherë u nisa te Pejgamberi dhe ia tregova ëndrrën. Resulullahu (a.s.), më tha:

"Këtu nuk ka ndonjë gjë për t'u habitur! Nuk ka njeri më të virtytshëm se besimtari që bën një jetë sipas Islamit dhe që nuk heq nga goja tesbihët, tekbiret dhe tehlilet." (Ahmed, I, 163.)

Pejgamberi (a.s.), për t'u treguar sahabëve vlerën e të jetuarit si mysliman, dha këtë shembull:

"Ai që vdiq në shtrat, a nuk bëri agjërim Ramazani?

A nuk fali brenda një viti gjashtë mijë e kusur rekatë?" (Ndaj dhe mes tyre do të ketë dhe kaq dallim.) (Ahmed, II, 333.)

Ky transmetim tregon se namazi bën dallimin e madh jo vetëm mes besimtarit dhe jobesimtarit, por edhe mes besimtarit dhe besimtarit, për nga aspekti i nivelit shpirtëror.

ATA QË NUK FALIN NAMAZIN

Njerëzit që janë larg namazit e kalojnë jetën e kësaj bote pa begati. Në fytyrat e tyre nuk mbetet më bukuria e nurit hyjnor. Këta njerëz mbesin pa dashurinë e njerëzve të sinqertë. Sipas enigmës së hadithit "Ju do të vdisni ashtu sikurse jetoni"[2], ata e kalojnë me rrezik frymën e fundit dhe japin shpirt me shumë mundime. Varri i ngushton ata dhe bëhet një nga gropat e xhehnemit. U kalon me shumë vështirësi të ndryshme llogaridhënia dhe përfundojnë në xhehnem.

Një mëngjes, Resulullahu (a.s.), u tha sahabëve:

"Këtë natë erdhën dy vetë (Xhebraili dhe Mikaili), më zgjuan dhe më thanë: Eja, na duhet të ikim. Dhe unë shkova bashkë me ta. Shkuam tek një njeri që po flinte në një krah. Pranë tij po qëndronte një tjetër me një shkëmb të madh në duar e po ia shtypte kokën me shkëmb atij që po flinte. Sa binte shkëmbi në një krah, shkonte menjëherë ta merrte. Sa bënte ai ta merrte shkëmbin, atij që flinte i rregullohej sërish koka si më parë. Kurse tjetri përsëriste goditjen me shkëmb në kokë të atij që po flinte dhe shkonte sërish të merrte shkëmbin...

Pyeta engjëjt:

- Subhanallah, ç'po ndodh këtu?

- Ta shpjegojmë ne, - më thanë. Ky njeri është një person që e ka ditur Kuranin përmendsh dhe e ka braktisur atë, si dhe është një njeri që lë namazin e obliguar (veçanërisht namazin e sabahut) dhe fle..." (Buhari, Ta'bir, 48, Xhenaiz, 93.)

Një i ri besimtar duhet të ruhet nga kurthet e shejtanit në këtë rrugë dhe duhet të nxitojë të falë kaza namazet që ka lënë për arsye të ndryshme. Ndaj dhe në hadith thuhet:

"Kush harron ndonjë namaz, le ta falë atë kur t'i kujtohet; nuk ka mënyrë tjetër shlyerjeje përveç kësaj." (Muslimi, Mesaxhid, 314.)

Kur nuk zbatohet kjo këshillë e Pejgamberit tonë, borxhet e namazit që janë mbledhur si një mal, në botën tjetër e shpien njeriun drejt falimentit.

PESË KOHËT E NAMAZIT

Secila nga pesë kohët e namazit ka vlerën dhe rëndësinë e vet. Ndarja e tyre në kohë të caktuara të ditës, si shpirtërisht ashtu edhe fizikisht për njeriun, ka një mijë dobi dhe urtësi. Ndaj dhe secila prej kohëve duhet kryer me kujdes dhe përkushtim.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i ka thënë ymetit, lidhur me pesë kohët e namazit:

"Allahu i Madhëruar më tha:

I kam bërë obligim për ymetin tënd pesë kohët e namazit. Kam dhënë një fjalë: kushdo që fal namazet në kohë, atë medoemos do e vendos në xhenet. Cilido që nuk i mbron ato namaze, për të nuk kam asgjë të premtuar." (Ibn Maxhe, Ikametus-Salah, 194.)

"Nëse një mysliman, kur vjen koha e namazeve të obliguara, merr mirë abdest, fal namazin si duhet, duke bërë kujdes rukutë dhe sexhdet dhe është i përkushtuar, nëse nuk ka bërë ndonjë gjynah të madh, ai namaz i shlyen atij të gjithë gjynahet e mëparshme. Kjo është formulë e përhershme." (Muslimi, Taharet, 7)

NAMAZI I XHUMASË

Namazi i Xhumasë është farz për meshkujt. Zoti i Madhëruar thotë:

"O besimtarë, kur të thirreni për** (të falur) **namazin** (e xhumasë) **në ditën e premte, nxitoni për

2. Munavi, Fejzul-Kadir, V, 663

ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!" (Xhuma, 9)

Sipas asaj që kuptohet nga ky ajet, gjatë kohës së faljes së Xhumasë është i ndaluar angazhimi me punë të tjera jashtë namazit të Xhumasë, sikurse është tregtia.

Resulullahu (a.s.), lidhur me namazin e Xhumasë ka thënë:

"Nëse një njeri merr abdest, vjen në namazin e Xhumasë dhe dëgjon hytben me qetësi, i falen të gjitha gjynahet që ka bërë që nga Xhumaja e kaluar dhe kësaj i shtohen edhe tri ditë. Kush luan me gurë, ndërkohë që dëgjon hytben, është zënë me punë të kota dhe ka humbur mirësinë e Xhumasë." (Muslimi, Xhuma, 27.)

"Nëse disa njerëz heqin dorë nga namazi i Xhumasë, edhe Allahu i Madhëruar do t'i vulosë zemrat e tyre dhe do të bëhen gafilë." (Muslimi, Xhuma, 40)

PËRKUSHTIMI NË NAMAZ

Të gjithë ibadetet duhen kryer brenda një entuziazmi të lartë shpirtëror. Veçanërisht namazi duhet falur me përkushtim. Në ajet thuhet kështu:

"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet." (Maun, 4-5)

Edhe Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Nëse njeriu e kryen namazin në mënyrë të saktë, duke bërë siç duhet rukunë dhe sexhden, namazi atij njeriu i thotë:

"Ashtu sikurse më ke mbrojtur mua edhe Allahu të mbrojtë ty!' Namazi ngrihet lart (dhe pranohet). *Nëse njeriu nuk e kryen saktësisht namazin, duke mos bërë sexhde dhe ruku siç duhet, namazi i thotë: Ashtu sikurse më ke humbur mua, edhe Allahu të humbtë ty!*

Namazi që fal, i mblidhet si paçavër dhe i përplaset për fytyrë." (Bejhakiu, Shuab, III, 143; Sujuti, Xhami, I, 58/364.)

Përkushtimi në namaz është aq i rëndësishëm, sa rruga për të arritur në shpëtim kalon përmes kësaj dere. Në ajet thuhet:

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përulur në namazin e tyre." (Mu'minun, 1-2)

Edhe Pejgamberi (a.s.), tregon në këtë mënyrë se pranohet namazi, nëse falet me përkushtim:

"Nëse një njeri kryen namazin, atij i shkruhet vetëm një e dhjeta, një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta, një e treta

ose gjysma." (Ebu Davud, Salat, 123 - 124/796; Ahmed, IV, 321)

"Nga namazi, njeriut i shkruhet vetëm pjesa e zemrës." (Suhejli, Ravdul-Unf, II, 208)

Pra, njeriu merr shpërblim nga namazi vetëm kur fal namaz me përkushtim dhe qetësi.

Gjatë namazit duhet bërë kujdes ndaj të gjitha rregullave të faljes. Një herë, Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Hajduti më i keq është ai që vjedh nga namazi i tij."

Sahabët e pyetën:

"O Resulullah, si mund të vjedhë njeriu nga namazi i tij?"

I Dërguari i Allahut ktheu këtë përgjigje:

"Atëherë kur nuk bën si duhet rukunë dhe sexhden. Kur ngrihet nga rukuja dhe sexhdeja dhe nuk e drejton mesin si duhet." (Ahmed, V, 310; Darimi, Salat, 78.)

Në një tjetër hadith, Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Allahu nuk e sheh (pranon) namazin e atij që nuk e drejton si duhet mesin mes rukuve dhe sexhdeve." (Ahmedi, II, 525.)

Sadoqë mund të përpiqemi të kryejmë me kujdes namazet, mund të mos i kryejmë si duhet. Jemi njerëz, kemi të meta dhe gabime. Ndaj dhe duhet të bëjmë kujdes t'i plotësojmë përmes drejtimit

nga Zoti me istigfar dhe me namaze vullnetare. I Dërguari i Allahut (a.s.), pati thënë kështu:

"Vepra e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kiametit është namazi. Nëse e ka kryer me rregull namazin, punët e tjera i shkojnë mbarë dhe del i fituar. Nëse nuk e ka të rregullt namazin, atëherë do të humbasë dhe do të dalë i dëmtuar. Nëse do të ketë ndonjë gjë të mangët nga farzet, atëherë Zoti që është Aziz dhe Xhelal, do të thotë:

"Pa shikoni, a ka namaze vullnetare?" Mungesën e farzeve e plotëson me namazet vullnetare. Pastaj edhe në veprat e tjera, i bëhet llogaria në këtë mënyrë." (Tirmidhiu, Salat, 188/413)

FALJA E NAMAZIT NË KOHËN E PARË

Falja e namazeve në kohën e parë është një prej çështjeve që kërkon kujdes. Përndryshe, të lësh namazin në kohën e fundit, duke e marrë me ngadalë dhe të falësh namazin me nxitim sikur po e heq qafe dhe pa dëshirë, Allahu na ruajtë, kjo gjë e çon njeriun në dyfytyrësi.[3]

Lidhur me vonesën që bëhet për të falur namazin, Resulullahu (a.s.), tërheq vëmendjen në këtë mënyrë:

"Në faljen e namazit në kohën e parë është pëlqimi i Allahut, ndërsa në kohën e fundit është mëshira e Allahut." (Tirmidhiu, Salat, 13/172)

3. Shih. en – Nisa, 142.

Pra, falja e namazit në kohën e parë, duke treguar kujdesin dhe vullnetin e qëndrimit rigoroz ndaj urdhëresave hyjnore, bëhet shkak për kënaqësinë e Allahut. Krahas kësaj, të tregohesh i shkujdesur ndaj namazit dhe ta falësh atë në kohën e fundit, tregon mungesën e kujdesit të bindjes ndaj urdhëresave hyjnore, nuk i jep njeriut ndonjë shpërblim, vetëm i jep mundësinë e shlyerjes së borxhit që ka ndaj farzit.

Hazreti Ala bin Abdurrahman rrëfen këtë ngjarje:

Një ditë pasdite patëm shkuar pranë Enes bin Malikut. Sapo shkuam ne, Enesi (r.a.), fali namazin e ikindisë. I thamë se po e falte herët. Ai, për të na e shpjeguar se përse bënte ashtu, na tha:

Pasi Pejgamberi (a.s.), tha tri herë; 'Ai është namazi i dyfytyrësisë!' vazhdoi kështu:

"Njëri prej tyre ulet, ulet, sapo të fillojë të perëndojë dielli, ngrihet sapo të hyjë në mesin e dy brinjëve të shejtanit, ashtu sikurse një zog që mbledh ushqim, me shpejtësi shtrihet e ngrihet katër herë, edhe në namaz e kujton shumë pak Allahun." (Muvatta, Kurani Kerim, 46; Muslimi, Mesaxhid, 195.)

Ebu Dheri (r.a.), na tregon:

"Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Si do të jetë gjendja jote kur të jesh në krye të njerëzve që vonojnë namazin apo që e kanë bërë atë si një kufomë, së cilës i ka dalë shpirti?"

Unë i ktheva përgjigje, duke pyetur:

"Ç'më urdhëroni në këtë gjendje?"

I Dërguari i Allahut (a.s.), më tha:

"Fale namazin në kohën e vet! Nëse mbërrin namazin kur janë duke u falur ata, sërish fale! Ky do të jetë për ty namaz nafile." (Muslimi, Mesaxhid, 238 - 240; Darimi, Salat, 25.)

Qe pyetur Pejgamberi ynë i dashur (a.s.):

"Cila prej punëve është më e virtytshmja?"

"Namazi që falet në kohën e parë." - pati kthyer përgjigje ai. (Ebu Davud, Salat, 9/426)

I Dërguari i Allahut (a.s.), këtë virtyt që ia kështillonte ymetit, pikësëpari e jetonte vetë. Ai pëlqente shumë të falte namazin sapo të hynte koha, në çfarëdolloj gjendjeje dhe kudo që të ishte.[4] Ndaj dhe Hazreti Aishja (r.a.), ka thënë:

"Allahu i Madhëruar e mori Resulullahun (a.s.), pranë Vetes, pa e vonuar as dy herë namazin për në kohët e fundit." (Tirmidhiu, Salat, 13/174; Ahmedi, VI, 92.)

4. Shih. Buhari, Salat, 48

Shefika Kaja Meriç

LE TË NDRIÇOJË DRITA JOTE

Çdo gjë fillon më të qenit **njeri.**

Pejgamberi ynë para se të gjithash ishte një **njeri**.

E gjithë çështja është e lidhur me këto dy fjalë: **një njeri** dhe **hapi i parë**.

Islami, ashtu siç i jep rëndësi jetës së një shoqërie, i jep rëndësi edhe jetës së një personi të vetëm. Gjendja shpirtërore e një njeriu pasqyrohet në gjendjen e tij fizike. Islami është feja e një grupi njerëzish por në të njëjtën kohë është edhe feja e një njeriu të vetëm sepse këto të dyja janë të lidhura ngushtë me njëra- tjetrën.

Pejgamberi (a.s) e ka çmuar shumë jetën e çdo personi aq sa ai nuk ka dëshiruar që asnjë person i vetëm të mos hyjë në xhehenem. Te shoku i tij më i afërt (shoku i shpellës), kjo ndjenjë u manifestua me shprehjen:

"O Zoti im, zmadhoje trupin tim në xhehenem në një mënyrë të tillë që askush tjetër të mos mund të hyjë."

Sehl ibni Sad (r.a) transmeton: Ka thënë Resulullahu (a.s.):

"...betohem në Allah se kthimi i një njeriu në rrugë të drejtë prej teje është më i mirë se zotërimi i deveve të kuqe." (Buhari, Fedailul Ashab 9, Megazi 38, Xhihad 102, 143; Muslim, Fedailus Sahabe)

Hadithi na mëson diçka shumë të rëndësishme. Ai na tregon një horizont që duhet të shtrihet para nesh. Pejgamberi na tregon se t'i tregosh dikujt rrugën e drejtë është një nga gjërat më të rëndësishme që mund të bëj një njeri.

T'i fitosh dikujt zemrën... Të pushtosh një zemër...

Le të mendojmë, a i dimë ne të gjithë rregullat e Islamit?! Ne kemi disa njohuri të marra nga familja jonë, të paktën shikojmë sjelljet e familjarëve tonë. Në rrugët tona dëgjohet zëri i ezanit, në qytetet tona ka xhamia. Në shoqërinë në të cilën jetojmë ka njerëz që i japin rëndësi vlerave fetare. Mund të themi se jemi njerëz të bekuar nga të mirat e Zotit.

Po njerëzit të cilët nuk i kanë këto të mira?! Kush do t'i tregojë atyre rrugën e drejtë?! Kush do t'ia shpjegojë atyre recetën e lumturisë?!

Le t'ju tregoj një histori nga jeta e Pejgamberit tonë të nderuar:

Ishte viti i shtatë i emigrimit (hixhretit)... Hajberi ishte një qytet i ndërtuar mbi një tokë vullkanike.

Ishte një qytet i fortë që zotëronte shtatë kështjella... Ky qytet i ndërtuar në rrugën e Shamit, ishte në veri-perëndim të Medinës.

Pjesa më e madhe e hebrenjve të cilët ishin larguar nga qyteti i Medinës për shkak se kishin thyer marrëveshjen me Pejgamberin ishin strehuar në këtë qytet.

Hebrenjtë kishin bërë një marrëveshje të re me politeistat e Mekes. Sipas kësaj marrëveshjeje nëse Pejgamberi do të kërkonte të sulmonte Meken populli i Hajberit do të sulmonte Medinen; nëse Pejgamberi do të sulmonte Hajberin politeistët e Mekes do të shtypnin Medinën. Kjo marrëveshje nuk u realizua.

Ushtria Islame ishte në një luftë me popullin e Hajberit i cili ishte kthyer në një strehë ku jetonin njerëz që përhapnin grindje. Besimtarët zotëronin një zell të pathyeshëm... Në zemrat e tyre ishte bindja që po luftonin në rrugën e drejtë dhe krah për krah me Pejgamberin, (a.s.). Beteja po zgjaste shumë dhe durimi i tyre filloi të lodhej. Tashmë kishte ardhur koha e një sulmi të bashkuar. Ditën pasardhëse do të bëhej një sulm i madh. Pejgamberi e kishte mbledhur ushtrinë dhe po i fliste:

"- Këtë flamur do t'ia jap dikujt me dorën e të cilit Allahu do të na siguroj çlirimin e Hajberit. Ai e do Allahun dhe Resulallahun, edhe Allahu dhe Resulallahu e duan atë."

Sa lajm i bukur ishte ky! Secili ishte i shqetësuar dhe i merakosur nëse Pejgamberi do t'ia jepte atij vetë këtë flamur...

Ato ishin aq të gëzuar nga lajmi se e nesërmja do të ishte një ditë fitoreje sa nuk mund të flinin dot.

Ditën e nesërme Pejgamberi ynë i nderuar kërkonte Hazreti Aliun mes të gjithë atyre syve të shqetësuar:

"- Ku është Aliu?"

Shkuan të thërrisnin Hazreti Aliun, i cili ishte larguar për shkak të një shqetësimi që kishte ndjerë në sy. Hazreti Aliu, i shëruar nga duaja që bëri Pejgamberi ynë po qëndronte para Tij me kokë të ulur. Pejgamberi ia dorëzoi Aliut trim flamurin e fitores dhe i tha:

"- Shko me kujdes pranë tyre, zbrit në fushën e tyre, pastaj ftoji në Islam. Shpjegoji atyre rregullat e nevojshme të Islamit. O Ali, kthimi i një njeriu në rrugë të drejtë prej teje është më i mirë se zotërimi i deveve të kuqe."

Në këtë mënyrë Pejgamberi na mëson se fitorja e vërtetë është çlirimi dhe fitimi i zemrave të njerëzve. Fitorja e vërtetë është kthimi në rrugën e drejtë... Kjo është një fitore aq e rëndësishme sa është më e çmuar se çdo gjë tjetër...

Pejgamberi (a.s.), i tha Hazreti Aliut se detyra e tij e parë është që t'i thërrasë njerëzit në rrugën e drejtë. Myslimanët i thërrisnin në Islam kundërshtarët para se t'i sulmonin ato.

Krahasimi që është bërë me devetë e kuqe vjen nga fakti se ato kanë pasur një vlerë shumë të madhe në atë kohë. Ne mund të bëjmë krahasim me gjënë më të shtrenjtë të kohës sonë, kjo gjë është përsëri më pak me vlerë se fitimi i një zemre dhe thirrja e saj në rrugë të drejtë.

Nga hadithi i Pejgamberit tonë të nderuar mund të nxjerrim këto mësime:

- Një njeri është çdo gjë. Shpëtimi i një njeriu është i barabartë me shpëtimin e gjithë njerëzimit.

- Ne e kemi detyrim që t'i njohim njerëzit me Islamin në mënyrën më të përshtatshme të mundur. Në qoftë se në kohën në të cilën ne jetojmë ka njerëz të cilëve nuk u ka mbërritur thirrja Islame ne kemi përgjegjësi (një pjesë të përgjegjësisë) për këtë gjë dhe Allahu do të na kërkojë llogari për këtë.

- Përpjekja kryesore e çdo myslimani duhet të jetë: thirrja në Islam. Duhet të punojmë për të lartësuar fenë e Allahut. Thirrja në Islam është farz për çdo mysliman deri në ditën kur do të vdes.

- Asgjë në këtë botë nuk është më e rëndësishme se shpëtimi i një njeriu. Njeriu duhet të bëj çdo sakrificë të nevojshme në mënyrë që të ndihmojënjë njeri tjetër për të gjetur rrugën e drejtë.

Allahu na bëftë prej njerëzve që ecin në rrugën e drejtë dhe që i ftojnë edhe të tjerët në këtë rrugë... Amin.

Duaja jonë:

Pejgamberi (a.s.) u bëri këtë dua njerëzve të Hajberit:

"O Allah, Zoti i qiejve dhe i të gjitha gjallesave!

O Allah, Zoti i tokës dhe i çdo gjëje që ndodhet mbi të!

O Allah, Zoti i shejtanëve dhe i atyre që kanë devijuar nga rruga e drejtë!

O Allah, Zoti i erës dhe atyre që ajo lëkund!

Ne urojmë të mirën e këtij qyteti, të mirën e këtij populli, të mirën e çdo gjëje që ndodhet në këtë qytet.

Kërkojmë mbrojtje tek Ti, prej të keqes së tij, të këtij populli dhe çdo gjëje që mban të keqen brenda." (Zadul- Mead, II, 148)

Dr. Betyl Nefise Inal

Syfyri dhe iftari

Qoftë i falënderuar Allahu që bëri të mundur shijimin edhe të një Ramazani tjetër. Këtë vit Ramazani qëlloi në ditët e gjata dhe të nxehta të verës. Në shikim të parë duket shumë e vështirë për të agjëruar në një ditë kaq të gjatë, por dihet se yndyra, proteinat dhe karbohidratet që depozitohen në trupin e një njeriu i mjaftojnë atij për të qëndruar pa ngrënë 70-75 ditë. Trupi i njeriut është ndërtuar në një mënyrë të tillë të mrekullueshme sa agjërimi në një ditë të gjatë vere nuk i sjell asnjë dëm.

Ramazani është një mundësi shumë ë mirë për të freskuar organizmin e lodhur gjatë gjithë vitit. Ramazani është një shërim për trupin dhe shpirtin në një kohë kur obeziteti është kthyer në një sëmundje ngjitëse, po shtohet përdorimi i produkteve të dëmshme për shëndetin, veset e këqija janë përvetësuar nga gjithkush madje edhe nga fëmijët, stresi është bërë pjesë ë pandarë e jetës sonë.

Për të përfituar nga të mirat e Ramazanit duhet të agjërojmë ashtu siç duhet. Shqetësimet që dëgjohen më shumë gjatë Ramazanit kanë lidhje me sistemin e tretjes, nuk mungojnë edhe lodhja, debulesa (dobësia) dhe dhimbja e kokës. Të gjitha këto shqetësime nuk vijnë nga agjërimi gjatë një dite të gjatë, por nga fakti se nuk është ngrënë si duhet në syfyr apo në iftar. Si duhet të jenë syfyri dhe iftari?

- Ashtu siç është i rëndësishëm mëngjesi kur fillojmë një ditë të re ashtu është i rëndësishëm edhe syfyri për agjërimin. Nuk duhet ta lini pas dore syfyrin, duhet të hani patjetër në syfyr.

- Duhet të konsumoni produkte që ruajnë ekuilibrin e sheqerit gjatë ditës, treten ngadalë, kanë vlera të larta ushqimore dhe që kanë përqindje të ulët kalorish. Ky regjim është i mirë edhe për njerëzit që kanë probleme me peshën e tepërt. Produktet kryesore që duhen konsumuar janë: ushqimet me fibër, ushqimet që kanë përqindje të lartë proteinash, perimet, frutat, frutat e thata dhe produktet që përdoren zakonisht në mëngjes. Supa, ushqimet me perime, frutat janë ushqime që treten më ngadalë dhe që sigurojnë ekuilibrin e sheqerit. Syfyri duhet të jetë në formën e mëngjesit dhe duhet të përmbajë: vezë, djathë, hurma dhe zarzavate. Nuk duhet lënë pas dore konsumimi i lëngjeve.

- Kur trupi i njeriut qëndron pa ujë, lindin shqetësime të ndryshme si: lodhje, marramendje, dhimbje të muskujve dhe kapsllëk. Këto shqetësime në të njëjtën kohë e bëjnë njeriun edhe më të stresuar dhe

të tensionuar. Mes kohës së iftarit dhe syfyrit duhet të merren masa për të plotësuar normën e lëngjeve. Pijet që përmbajnë kafeinë nuk janë të këshilluara sepse ato bëhen shkak për humbjen e lëngjeve. Pijet të cilat duhen konsumuar janë: uji, qumështi, dhallë dhe lëng frutash.

- Mendimi që dita është e gjatë prandaj është mirë që të ha sa më shumë në syfyr është i gabuar. Ushqimet pikante, fërgesat dhe brumërat janë të dëmshme për sistemin e tretjes, krijojnë lodhje dhe bëhen shkak që njeriun ta marrë uria më shpejt.

- Rasti kur nuk flihet deri në kohën e syfyrit bën që të zgjatet koha që qëndrojmë pa ngrënë dhe gjatë ditës vihen re shqetësime si dobësia, lodhja dhe dhimbja e kokës. Duke qenë se flihet menjëherë pas ushqimit stomaku fillon të ndjej shumë shqetësime, prandaj është më mirë që pas ngrënies të qëndrojmë zgjuar për pak kohë sepse përveç se i bën mirë shëndetit tonë, na ndihmon neve që të përfitojmë nga kjo kohë e bekuar e ditës.

- Njerëzit që janë të sëmurë mund të agjërojnë duke pirë ilaçet e tyre në syfyr. Sipas studimeve: përqindja e shërimit tek njerëzit që kurohen kundër një sëmundjeje të caktuar dhe që në të njëjtën kohë agjërojnë është më i madh se përqindja e njerëzve që kurohen por nuk agjërojnë. Teksa tek të sëmurët me ulçerë të cilët qëndrojnë pa ngrënë për një kohë të gjatë (jo duke agjëruar) është vënë re rritja e sasisë së acidit në stomak; tek të sëmurët me ulçerë që agjërojnë sasia e acidit në stomak ulet.

- Kur ne agjërojmë të gjitha organet janë të lumtura. Sikur agjërimin që mban stomaku ta mbanin edhe pjesët e tjera të trupit do të ishte shumë mirë. Durimi që tregojmë gjatë ditës duhet treguar edhe në iftar, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të matur gjatë ngrënies në iftar. Le të kuptojmë vlerën e agjërimit dhe të hamë pak, gjithnjë duke falënderuar Allahun. Produktet më të këshilluara janë: uji, hurmat, frutat e thata dhe ullinjtë. Hurma është një frut ideal për iftarin, ajo rregullon sheqerin në gjak, plotëson nevojat për minerale dhe ka fibra të dobishme për shëndetin tonë.

- Ngrënia e ngadaltë e një supe dhe sallatat e ndryshme ngopin njeriun dhe largojnë etjen. Para se të filloni ngrënien e ushqimit kryesor duhet të jepni një pushim prej 10-15 minutash. Iftaret që përfundohen me shpejtësi japin dhimbje në stomak. Gjatë pushimit që japim është mirë që të falim namazin e akshamit sepse në këtë mënyrë i japim sinjal trupit tonë për t'u ngopur më shpejt. Ngrënia në këtë mënyrë zvogëlon mbingopjen dhe nuk e rëndon sistemin e stomakut dhe të zorrëve.

- Ushqimet kryesore të vaktit duhet të jenë të lehta, duhen ngrënë ngadalë dhe duhen zgjedhur produkte si perimet, mishi i bardhë dhe ushqimet e ziera. Nëse bëhet iftar me ushqime të rënda njeriu ka lodhje dhe atij i vjen gjumë. Fjetja menjëherë pas ngrënies është e dëmshme për shëndetin.

- Nuk duhet lënë mbas dore pirja e sa më shumë lëngjeve. Një nga gabimet që bëhet shumë shpesh është pirja e çajit gjatë ngrënies së iftarit. Çaji dhe pijet me kafeinë që pihen gjatë ushqimit zvogëlojnë aftësinë e marrjes së vitaminave, në veçanti të hekurit. Uji është pija më e shëndetshme. Çaji duhet pirë pak pas ushqimit.

- Nuk duhet t'i lëmë pas dore frutat. Frutat e stinës kanë ujë dhe gjithashtu në ndihmojnë që të marrim mineralet e nevojshme.

- Gjatë Ramazanit rritet dëshira për të ngrënë ushqime të ëmbla. Është e këshillueshme që në vend të ëmbëlsirave me shërbet të bëra nga brumi të konsumohen ëmbëlsira të bëra me qumësht, hurma, fruta të thata dhe komposto jo shumë të ëmbla.

- Sigurisht që gjatë Ramazanit ne jemi më pak aktivë, por kjo nuk do të thotë që mund të kalojmë të gjithë ditën duke fjetur dhe të bëjmë që agjërimi i jonë të mos jetë asgjë tjetër veçse një uri pa vlerë. Mbas ngrënies së iftarit mund të bëhet një shëtitje e shkurtër. Duhet të përpiqemi që të hamë një iftar të lehtë, në mes të ushqimit të rezervojmë pak kohë për namazin e akshamit, të falim namazin e jacisë dhe teravisë me xhemat në mënyrë që t'i japim hakun e duhur agjërimit. Në këtë mënyrë ne kujdesemi ashtu siç duhet për trupin dhe shpirtin tonë.

- Duhanpirësit bëjnë gabimin më të madh duke pirë duhan menjëherë me stomakun bosh. Ramazani duhet shfrytëzuar si një rast i mirë për të shpëtuar nga veset që janë të dëmshme për shëndetin tonë.

- Në mënyrë që Ramazani të na gjejë të përgatitur është mirë që të agjërojmë edhe gjatë dy muajve të shenjtë që paraprijnë Ramazanin. Pejgamberi ynë i nderuar agjëronte më shumë gjatë Shabanit se gjatë Rexhepit, nga kjo kuptojmë se ne duhet të mësohemi ngadalë me agjërimin. Për të përfituar nga të mirat që i sjell shëndetit tonë agjërimi duhet të mundohemi që të agjërojmë sa më shumë edhe gjatë gjithë vitit, ashtu siç ka bërë shembulli ynë i përsosur: Pejgamberi (a.s.).

Siç ka thënë Allahu në Kuran:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun." (Ahzab, 21)

Neslihan Nur Turk

KATËR LIBRAT E SHENJTË

Një shoqe e imja kishte bërë disa anketa në të cilat i pyeste njerëzit (kryesisht të besimit Islam) se cilët janë katër librat e shenjtë; përgjigjet që kishte marrë e kishin habitur shumë.

Pyetja e saktë që u kishte drejtuar njerëzve ishte:

"- Cilat janë katër librat e shenjtë që Allahu u ka dërguar njerëzve dhe me anë të cilëve pejgamberë i ka dërguar?"

Përgjigjet që kishte marrë ishin shumë të ndryshme nga njëra- tjetra dhe disa prej tyre ishin mjaft qesharake.

Pjesa më e madhe e tyre kishin përmendur me lehtësi Kuranin dhe pejgamberin të cilit i është zbritur, Hazreti Muhamedin (a.s.). Tek dhënia e përgjigjes sa i përket librave të tjerë të gjithë kishin pasur pak vështirësi... Disa prej tyre i kishin bërë bisht pyetjes duke u justifikuar se kanë punë dhe duhet të largohen...

Në fakt kjo është një çështje prej të cilës duhet të shqetësohemi. Nuk kërkoj të tallem me njerëzit që nuk i dinë këto gjëra kaq elementare, por më shqetëson fakti që në vend të këtyre nuk hezitojmë të mësojmë përmendësh shumë gjëra të tjera të parëndësishme...

Shumë njerëz nuk e kanë aspak problem që të numërojnë malet, lumenjtë dhe fushat e shumë vendeve...

Kemi shumë të rinj të cilët nuk e kanë të vështirë të flasin për lidhjet e aktorëve, këngëtarëve apo njerëzve të tjerë të njohur pa asnjë vështirësi...

Ka njerëz të cilët i dinë shumë mirë markat e makinave, vitet e tyre të krijimit dhe janë të aftë edhe për të bërë krahasime mes makinave të ndryshme...

Të tjerë mund të tregojnë me shumë saktësi se në cilin vit ka filluar një futbollist që të luaj për një skuadër, sa është shuma që është paguar për transfertën e tij, jetën e tij private, arsyet që ka pasur performancë të dobët në filan ndeshje dhe i përshkruajnë golat që ka shënuar sikur të kishin ndodhur para pak çastesh...

Ka njerëz që marrin informacione të sakta për filmat që nuk kanë dalë akoma në kinematë botërore...

Ka njerëz që e rregullojnë të gjithë programin e tyre ditor në mënyrë që të mos humbasin asnjë sekondë nga telenovela e tyre e preferuar të cilës ia dinë të gjitha hollësitë...

Pse të rinjtë tanë të cilët e tregojnë me saktësi se filan këngëtar ka nxjerr albumin e parë në këtë vit dhe ka bërë këngë me këtë këngëtarin tjetër, kur bie fjala për temat fetare fillojnë të belbëzojnë...

A nuk është e çuditshme kjo gjë?

Pse të rinjtë tonë i mësojnë me lehtësi këngët e huaja, arrijnë të imitojnë edhe theksin e tyre por kur vjen fjala për të mësuar një sure apo dua ngurrojnë dhe nuk tregojnë interes?

Është shumë e vërtetë se bëhet shumë propagandë që na largon nga mësimet e fesë por a është e drejtë që gjithmonë të qëndrojmë pasiv? A nuk do të bëjmë asgjë teksa shohim kulturën dhe edukatën tonë duke u thërrmuar?

A do t'ia japin të huajve të drejtën për të ruajtur

fëmijët tonë dhe për t'i mësuar atyre moralin dhe atdhetarizmin? A do të themi:

"- Amerikanët bëjnë filma shumë të bukur, ah sikur edhe ne të mund të bënim filma të tillë dhe t'ia tregonim fëmijëve tonë?!"

Apo do të përdorim këtë fjali:

"– Misionerët dinë shumë mirë se si të ndikojnë tek njerëzit, sa mirë do të ishte sikur të shpjegonin diçka edhe për fenë islame!"

Mos vallë do të përdorim këtë fjali:

"– Sa mirë do të ishte që kjo gruaja që ka shkruar Harri Poterin të shkruante libra edhe për gjërat që kemi jetuar ne dhe për heronjtë tanë të panumërt!"

Sigurisht që në shikim të parë këto fjali duken shumë pa kuptim por në të vërtetë këto ekzistojnë në nënndërgjegjen tonë. Të huajt janë më të mirë se ne në çdo fushë; sepse ato janë të qytetëruar, të zgjuar dhe të aftë...

Ato janë më lart se ne...

Ka ardhur koha që të shpëtojmë nga ky kompleks inferioriteti . Le të mësojmë fenë tonë dhe t'ia përcjellim edhe të tjerëve këtë gjë!

Feja jonë na këshillon që të punojmë ndërsa ne zgjedhim dembelizmin... Feja jonë na thotë që të jemi të guximshëm të paktën sa armiku kurse ne qëndrojmë të fshehur në guacka... Feja jonë inkurajon dijen kurse ne e kalojmë ditën duke u dhënë pas argëtimeve të pavlera... Feja jonë na kërkon të punojmë për këtë dynja duke marrë parasysh kohën që do të qëndrojmë këtu dhe të punojmë për ahiretin duke marrë parasysh kohën që do të jetojmë atje kurse ne jetojmë sikur ahireti të mos ekzistonte... Kemi harruar botën tjetër, vdekjen, xhenetin dhe xhehenemin...

Ne jemi bërë njerëz dembel, frikacakë dhe koprracë ... Ai që fiton pushtet bëhet i pamëshirshëm kurse ai që nuk ka gjë në dorë mbetet mjeran. Më e keqja i ndodhi fesë sonë, askush nuk i del më përzot asaj.

U justifikuam duke thënë se nuk kemi rrugë tjetër:

"Familja ime di shumë gjëra për fenë..."

Familja juaj mund të ketë njohuri për fenë por ne sa prej këtyre njohurive i kemi marrë dhe praktikuar në jetë? Sa të lidhur jemi ne me Islamin? A lexojmë ne libra që flasin për fenë tonë? Sa e njohim Allahun, Pejgamberin dhe librin e zbritur nga Allahu? Sa i kryejmë ne adhurimet ? Si i kemi marrëdhëniet me njerëzit e tjerë?

Më ka bërë shumë përshtypje diçka... E kane pyetur një japonez mbi faktin se si e kanë arritur këtë zhvillim... Ai është përgjigjur se zhvillimi i arrirë vjen nga lidhja që kanë me fenë e tyre.

Pastaj e kanë pyetur:

"– Cilat janë urdhrat e fesë suaj?"

Japonezi i është përgjigjur:

"– Puna, sinqeriteti, bërja mirë e punës dhe sjellja e mirë..."

Njerëzit janë çuditur dhe i kanë thënë:

"- Edhe feja jonë i urdhëron këto gjëra."

Japonezi i ka dhënë një përgjigje që i ka lënë pa fjalë të gjithë:

"- Mund të jetë ashtu siç thoni ju, por po kuptoj që ju nuk i zbatoni urdhrat e fesë suaj."

Kjo është çështja kryesore... Ne nuk i zbatojmë ato gjëra që i dimë... Nëse do të më pyesni se nga mund të filloni që të mësoni fenë tonë unë ju këshilloj që të merrni një libër ilmihali! Lexoni dhe praktikoni ! Do të shikoni se në momentin që ju do të praktikoni njohuritë e marra, Allahu (xh.sh) do t'ju mësojë gjërat që nuk i dini...

Pejgamberi ynë i dashur ka thënë:

"Ato që thanë se do të veprojnë nesër shkuan drejt humbjes!"

Mos e shtyni më gjetjen e rrugës së drejtë; filloni sot...tani...

Halime Demireshik

NË FUND MË BËRI DOBI VETËM ILMIHALI

Një vajzë e re që sapo kishte filluar të falte namaz, kishte marrë abdest dhe ishte nisur për tek puna me qëllimin për të falur drekën dhe ikindinë aty, sepse ishte më e lehtë për të. Teksa po fillonte të falte namazin dëgjon zërin e disa shoqeve:

"- Ti erdhe pa shami nga shtëpia prandaj të është prishur abdesti, nuk mund të falësh namaz..."

Vajza e shkretë nuk gjeti një vend të përshtatshëm për të marrë abdest dhe u detyrua që t'i linte namazet pa falur. U mërzit dhe filloi të mendonte :

"– Nëse më prishet abdesti kur nuk kam shami në kokë do të thotë që më duhet të qëndroj gjithmonë e mbuluar !"

Vajza merrte abdest por nuk vendoste shami dhe detyrohej që t'i linte namazet për t'i falur kaza.

Pas një periudhe filloi të mos i pëlqente më namazi, të lodhej prej tij; por nga ana e tjetër e kuptoi se nuk mund të mbaronte kjo çështje vetëm nga një mendim që i kishin dhënë disa shoqe që nuk falnin namaz dhe filloi të mendonte se prej kujt mund të gjente një përgjigje më të saktë. Shkoi të gjente disa libra dhe harxhoi tre ditë të tëra për të gjetur librat e përshtatshëm dhe më në fund kishte vendosur që të merrte një libër ilmihali. Le të shohim se çfarë ndodhi pas kësaj:

"– Nëse duhet të themi të vërtetën, praktikimi i fesë ka qenë i vështirë për mua sepse nuk kam askënd që të më ndihmojë në kuptimin e disa gjërave. Familja sikur të dinte ndonjë gjë do të më kishte mësuar. Ka qenë e vështirë për mua sepse çdo gjë e kam bërë duke u bazuar në supozimet e njerëzve ."

Gjëja e parë që bëra kur shkova në shtëpi ishte hapja e librit dhe leximi i pjesës që fliste për pastërtinë. Prishja e abdestit nga qëndrimi pa shami nuk ishte askund, por kishte shumë gjëra që e prisnin abdestin dhe që unë nuk i dija. I lexova të gjitha me kujdes. Kur lexova pjesën që fliste për gusulin u habita shumë. Unë tashmë merrja gusul si një veprim që kryhet nga çdo njeri normal, por nuk i dija sunetet e tij. Nuk e dija se është sevap marrja e gusulit ditën e premte. Nuk e dija se kur bënim gabim gjatë një namazi mund të bënim sehvi sexhde. Unë gjithmonë e prishja namazin për t'ia filluar nga fillimi kur bëja ndonjë gabim.

Agjërimin gjatë muajit të Ramazanit e kam filluar pas universitetit. Kur unë isha agjërueshëm një shoqe më tha:

"- A fal namaz ti? Nuk ka vlerë agjërimi nëse nuk falesh!"

Unë doja që të më pranohej agjërimi prandaj fillova të mësoj sesi falet namazi; por për shkak të asaj njohurie të gabuar që më tha shoqja unë nuk agjërova më. Pasi mësova sesi falej namazi vazhdova të agjëroj.

Ne librin që po lexoja nuk kishte diçka që të thoshte se mosfalja e namazit e prish agjërimin. Kjo nuk ishte një nga arsyet e prishjes së agjërimit prandaj unë mendova se mos në këtë libër mungon ndonjë gjë dhe vendosa të pyes dikë në lidhje me këtë çështje. Nuk mund t'i besoja fjalës së çdokujt prandaj shkova në myftini.

Myftia buzëqeshi dhe më tha që qëndrimi pa shami nuk e prish abdestin dhe se mosfalja e namazit nuk e prish agjërimin por njeriu që e di se namazi është detyrim dhe nuk e fal atë bën mëkat.

Ai shtoi se falja e namazit nuk ishte detyrim vetëm gjatë muajit të Ramazanit, por në çdo ditë të vitit. Falja e namazeve është obligim për çdo besimtar dhe mosfalja e namazit është haram.

Kisha fituar njohuri të reja, por në të njëjtën kohë isha përballur dhe me shumë terma të panjohur.

Çfarë ishte harami, suneti dhe farzi?

Zotëria myfti më dhuroi një libër që përmbante temat e besimit, adhurimit, moralit dhe jetës së Pejgamberit. E lexova me kujdes dhe mësova thelbin e këtyre fjalëve. Shoqet e mia nuk e donin Azrailin, në fakt ato nuk i njihnin engjëjt e tjerë, por nuk i kisha dëgjuar asnjëherë të thoshin fjalë të mira për Azrailin. Nga ai libër mësova se ai është një melek (engjëll) të cilit Allahu i ka lënë një detyrë... Detyra e Tij është që t'ia marrë shpirtin njerëzve në momentin e duhur dhe për këtë ai nuk ka asnjë faj. Unë fillova që ta doja atë pa e pasur frikë. Më pas kur fillova që të lexoj Kuranin së bashku me shpjegimin e Tij mësova për engjëjt që ia merrnin shpirtin njerëzve dhe se njerëzve që kishin bërë gjëra të mira iu dilte shpirti më kollaj. Azraili nuk kishte asnjë faj, faji ishte i njerëzve që nuk kryenin vepra të mira.

Diçka tjetër që më kishte bërë shumë përshtypje ishin edhe kushtet e besimit. Kur i mësova ato kuptova se nuk e njihja siç duhej Allahun. Është e vërtetë se në gjimnaz, në mësimin e fesë kishim mësuar diçka në lidhje me këtë temë, por ato i kisha mësuar përmendësh për t'i harruar shumë shpejt. Gjatë shkollës kishim mësime më të rëndësishme të cilave duhej t'i kushtonim më shumë kohë(!). Për më tepër që thelbi i mësimeve tona kishte lidhje me kulturën dhe jo me fenë. Nuk kemi ndjekur mësime që të na mësonin sesi të falnim namaz. Ne kishim mësimin e fesë, por në të flitej vetëm për moralin, për dashurinë për mjedisin, për dashurinë për atdheun; unë besoja se feja jonë ishte e përbërë nga këto gjëra.

Nuk e dija se cilat ishin temat kryesore të Islamit. Si duhet të jetojë një besimtare, cilat janë adhurimet që duhet të bëjmë, çfarë është zekati?

Ne kishim mësuar vetëm përkufizimin e një fjale, vetëm kaq!...

Kur po lexoja librin e Ilmihalit e kuptova se pjesën më të madhe që mësuesi na i kishte mësuar për të falur namazin na i kishte mësuar gabim. Unë lexoja gabim edhe suren Fil. Kuptova se i kisha mësuar gabim! Mendova se do të ishte mirë sikur të merrja disa CD me suret e Kuranit. I dëgjoja CD-të dhe bëja përpjekje për t'i korrigjuar gabimet e mia por gjithsesi kisha nevojë që të punoja me dikë dhe vendosa që të trokas përsëri tek dera e myftisë. Ai më këshilloi që të shkoja tek një kurs Kurani. Sa herë që kisha mundësi vrapoja drejt këtij kursi. Nuk bëja më pushime gjatë drekës vetëm për të punuar me leximin e Kuranit sepse kjo ishte një temë shumë e rëndësishme për mua.

Fillova që të mësoja dhe shumë tema të tjera me mësuesen time, i bëja shumë pyetje asaj për të përmirësuar njohuritë që kisha marr nga njerëz të ndryshëm.

Shoqet e punës qeshnin me mua dhe më jepnin këshilla sipas mënyrës së vet:

"– Ke mbetur pa ngrënë, mendon më shumë seç duhet. Kjo që po bën nuk do të sjell asnjë të mirë vetëm do të trazoj mendimet. Mos u thello më shumë seç duhet, sillu si ne. Bëhu si ne dhe do të të mjaftojë."

Asgjë nuk ishte ashtu siç thoshin ato... Njeriut që mëson Kuran nuk i trazohen mendimet, por i forcohet besimi dhe i pasurohet shpirti.

Një shoqe e imja ishte shqetësuar aq shumë nga gjendja ime saqë kishte marrë në telefon familjen time dhe i kishte thënë:

"– Më duket se vajza juaj është përzier me grupet fetare, nuk i lëshon librat fetarë për asnjë çast! Shumë shpejt mund të mbulohet prandaj hajdeni për t'u marrë me të!"

Prindërit e mi që nuk më kishin vizituar asnjëherë gjatë të gjitha viteve që kisha kaluar si studente erdhën me vrap për të më shpëtuar... Ato ditë ishin shumë të vështira për mua. Isha e detyruar që të

harxhoja shumë kohë për t'i shpjeguar atyre se çfarë bëja dhe se si ndihesha. Shpesh herë ato më silleshin ashpër. Nëna qante me qëllimin për të më prekur mua. Unë bëja përpjekje për t'i shpjeguar se unë po mësoja për fenë time, po mësoja ato gjëra që duhet t'i kisha mësuar shumë kohë më përpara. I tregova atyre se po mësoja vetëm gjërat më të rëndësishme të fesë sonë dhe se po mësoja leximin e saktë të Kuranit në mënyrë që mos të gaboja në faljen e namazit. I tregova prindërve të mi librat që po lexoja.

Kur shikuan që unë falja pesë vaktet e namazit, agjëroja ditën e hënë dhe të enjte dhe ngrihesha natën për të falur namazin e tehexhudit më thanë:

"-Kjo që bën ti është e tepruar, je duke e lodhur shumë veten!.."

Nuk e kuptuan faktin se agjërimi që bëja unë ishte një nga sunetet e Pejgamberit (a.s)... I tregova dhe që Pejgamberi ynë ngrihej çdo natë për të falur namazin e natës, por nuk më kuptuan. I kujtova atyre se kur më kishin dërguar në kryeqytet i kisha thënë që jam e lodhur dhe nuk dua të shkoj por ato gjithsesi më kishin dërguar:

"– Unë shkova atje vetëm sepse ju e dëshironit një gjë të tillë. U lodha, por përfitova shumë gjëra dhe nuk pata asnjë të keqe prej saj. Nga stërvitjet që bëra mësova të jetoj në mënyrë të rregullt, të ushqehem në mënyrë të shëndetshme dhe të qëndroj larg gjërave si alkooli dhe cigarja. Edhe tani jam duke bërë të njëjtën gjë; agjëroj, falem, jetoj në mënyrë të shëndetshme."

Ata më thanë që sporti nuk është i dëmshëm, por që këto tema janë të rëndësishme.

Kur unë isha në punë babai i kishte marr të gjithë librat që lexoja dhe ia kishte dërguar myftiut. E kishte pyetur atë:

"- Mos vallë vajza ime është bashkuar me bashkësi të gabuara?"

Myftiu ishte kujtuar për mua dhe ia kishte shpjeguar babit tim gjendjen në të cilën ndodhesha. Babai filloi që ta vizitonte shpesh myftiun. Pas pak ditësh u detyruan që të ktheheshin në qytetin e tyre për shkak të punëve. Unë i thashë babait:

"- Kam mësuar se nëse një mysliman nuk i mëson gjërat të cilat duhet t'i mësoj atëherë Allahu do ta pyes *Pse nuk i ke mësuar?*"

Babai im u prek shumë nga këto fjalë.

Prindërit e mi filluan të turpëroheshin, sepse nuk më kishin mësuar asgjë në lidhje me fenë. Më shumë u turpërua babai im sepse sipas fesë sonë shpjegimi i fesë një fëmije është detyrë e babait më shumë se e nënës. Nëna ime nuk kishte shkollim, kishte përfunduar vetëm shkollën fillore. Babai kishte përfunduar universitetin dhe ishte detyra e tij që të mësonte rregullat e fesë dhe më pas të na i transmetonte edhe neve. Po sikur Allahu nuk do të më kishte ndihmuar që të mësoja gjërat që i kisha mësuar këto kohët e fundit?

Tashmë unë mund të lexoj Kuran, në të njëjtën kohë përpiqem që të lexoj sa më shumë libra me shpjegimin e sureve të Kuranit. Nganjëherë kam pyetje që vijnë nga rreshtimi i sureve në Kuran në mënyrë të ndryshme nga rendi kronologjik, në të tilla raste shkoj dhe pyes myftinë.

Dëshira ime më e madhe në këto çaste është që të vizitoj vendin ku

Diçka tjetër që më kishte bërë shumë përshtypje ishin edhe kushtet e besimit. Kur i mësova ato unë kuptova se nuk e njihja siç duhej Allahun. Është e vërtetë se në gjimnaz, në mësimin e fesë kishim mësuar diçka në lidhje me këtë temë por ato i kisha mësuar përmendësh për t'i harruar shumë shpejt.



Kur po lexoja librin e Ilmihalit e kuptova se pjesën më të madhe që mësuesi na i kishte mësuar për të fal namaz na i kishte mësuar gabim. Unë lexoja gabim edhe suren Fil. Kuptova se i kisha mësuar gabim!

ka jetuar Pejgamberi ynë i nderuar, t'i bëj një vizitë vendeve të shenjta.

Mësuesja ime e fesë kishte shumë kuriozitet që të mësonte se si isha njohur unë me fenë, me rregullat e fesë. Ajo të gjitha themelet e fesë i kishte mësuar në mënyrë të pandërgjegjshme, që në moshë të vogël. Nëna e saj e kishte dërguar në kurse Kurani që në fëmijëri pastaj ajo me dëshirën e vet kishte ndjekur fakultetin e teologjisë.

Një ditë i thashë mësueses sime:

"– Unë ju kam shumë zili juve sepse e keni mësuar shumë bukur fenë tonë!"

Ajo m'u përgjigj:

"– Në fakt unë të kam zili ty sepse unë e kam mësuar fenë duke imituar të tjerët kurse ti e ke mësuar me përpjekjet që ke bërë... Ti je munduar për të gjetur rrugën e drejtë. Ti ke fituar më shumë sevape se unë... Unë e kam gjetur gjithçka të gatshme nga njerëzit që me rrethonin kurse ti e ke kërkuar dhe fituar vetë çdo gjë. Ke gabuar nganjëherë por gjithmonë e ke kuptuar gabimin dhe je drejtuar nga rruga e drejtë, nuk je dorëzuar asnjëherë, Allahu të do ty më shumë se mua."

Unë u gëzova shumë. Në fakt edhe unë besoj se Allahu më do. Zoti im më do dhe prandaj më ndriçoi rrugën që duhej të merrja, apo siç thotë mësuesja ime e dashur: "Më drejtoi mua drejt shpëtimit". Unë jam shumë mirënjohëse për këtë gjë.

Dikur kisha dëgjuar diçka të tillë nga një gjyshe:

"Kush nuk mëson fenë e vërtetë mbetet injorant

Ka pamje të ngjashme me njeriun por nuk është gjë tjetër veçse kafshë."

Tashmë unë i kuptoj dhe i vlerësoj më mirë këto fjalë.

***

Shembulli i kësaj vajze të re është shumë i njohur për ne.

Ka shumë njerëz që nuk i dinë njohuritë bazë të fesë të cilat duhet t'i kishin mësuar që në moshë të vogël... Mbase nuk është turp të mos i dish këto gjëra, turp është të mos mundohesh për t'i mësuar... Nuk mund të justifikohemi me fjalinë: "Familja ime nuk më ka mësuar fenë!"... Ka shumë njerëz të cilët e njohin mirë fenë dhe që janë të gatshëm për të na e mësuar neve.

Nuk jetohet Islami me fjalë të dëgjuara këtu e aty. Nëse mjaftohemi me aq, do të na ndodhë dhe në gjërat që kanë ndodhur me këtë vajzë të shkretë. Gjatë jetës sime kam kuptuar se njerëzit që nuk e mësojnë fenë islame nga burimet e sakta jetojnë më shumë duke respektuar bidatet dhe paragjykimet. Nuk ka rëndësi nëse mësojmë njohuri në lidhje me fizikën, matematikën apo kiminë; ose nëse bëhemi profesor apo drejtor; rëndësi kanë njohuritë fetare që marrim dhe praktikimi i tyre... Allahu dëshiron që të gjithë ne të mësojmë fenë tonë dhe ta jetojmë atë.

Fjalët e fundit të një profesori që po luftonte me kancerin dhe që në ditët e fundit të jetës së tij po mundohej të kuptonte fenë duke lexuar libra ilmihali ishin:

"– Zemra ime është shumë e lënduar sepse çdo njohuri që kam marrë paska qenë e pavlerë. Në fund më bëri dobi vetëm ilmihali ! .."



Vendosja E UNAZËS

Kevser Atar

Pejgamberi (a.s.) dhe shokët etij të bekuar pasi kaluan trembëdhjetë vite shumë të vështira në Meke shtegtuan për në Medine dhe themeluan aty: "Shtetin Islam të Medinës". Kjo ishte një alenacë politike e krijuar mes fiseve të ndryshme që jetonin në Medine dhe në rrethinat e saj. Sigurisht që kryetari i këtij bashkimi politik ishte Pejgamberi ynë i nderuar. Marrëveshja e shkruar në të cilën përmendet emri i Tij ka mbërritur deri në kohët e sotme dhe është **"Kushtetuta"** e parë e njohur. Një veçori e kësaj marrëveshje është fakti se në të janë përcaktuar kufijtë e shtetit Islam të Medinës.

Kishin kaluar shtatë vjet qëkur myslimanët ishin vendosur në Medine dhe kishin krijuar shtetin Islam kur Pejgamberi (a.s) vendosi që t'i dërgonte nga një letër shteteve fqinjë për t'i bërë ftesë në Islam. Sigurisht që njohja e një shteti të ri nga shtetet tjera është shumë e rëndësishme.

Mbas përgatitjes së letrave që i bënin thirrje shteteve fqinjë për të përqafuar islamin lindi një problem;

Disa nga sahabët iu drejtuan Pejgamberit me fjalët:

"– O i Dërguar i Allahut!.. Drejtuesit e shteteve nuk i pranojnë letrat që nuk kanë vulë. Ato nuk i marrin parasysh letrat që u nisen pa vulë, ia nisim kot!.."

Pejgamberi ynë e mori parasysh këtë këshillë dhe kërkoi përgatitjen e një vule menjëherë. Përpara kësaj ndodhie në Hixhaz (zona e Mekes dhe Medines) nuk ishte përdorur vulë. Sipas transmetimeve mësohet se kjo vulë ishte prej argjendi. Në të gjendej shkrimi: "Profeti Muhammed" , më vonë kjo vulë u kthye në unazë dhe filloi që të përdorej nga Pejgamberi ynë. Kjo ishte hera e parë që Pejgamberi ynë vendosi një unazë në gisht. Disa

prej sahabëve kërkuan që të bënin të njëjtën gjë, të prodhonin një unazë të ngjashme dhe ta vëndosnin në gisht; por duke qenë se kjo unazë ishte simboli i shtetit Pejgamberi ua ndaloi këtë gjë sahabëve të vet duke i thënë:

"Askush të mos bëjë një unazë që i ngjan unazës që mbaj unë." (Buhari, VII, 53; Ebu Davud, IV, 125.)

Pas vdekjes së Pejgamberit salallahu (a.s.) i kaloi Hz. Ebu Bekrit (r.a.) pas tij i kaloi Hz. Omerit (r.a.) pastaj i kaloi Hz. Osmanit (r.a.). Sipas transmetimeve, kjo unazë i humbi Hz. Osmanit (r.a.) duke i rënë në pusin Eris në vitin e tij të gjashtë si kalif.

Kalimi i kësaj unaze në duart e këtyre njerëzve tregon se ajo nuk ishte një send personal por pronë e shtetit islam.

Nga ky shpjegim kuptojmë se Pejgamberi (a.s.), nuk e kishte ndjerë asnjëherë nevojën e të mbajturit unazë, por e kishte vendosur atë vetëm si një detyrim që i lindte nga të qenurit kryetar shteti. Duke u nisur nga kjo dijetarët Hanefi kanë thënë:

"Nëse nuk është e nevojshme është më mirë që të mos vendoset unazë pavarësisht materialit nga i cili është prodhuar; kurse për njerëzit që kanë poste të tilla si kadi, sulltan etj, mbajtja e unazës është sunet."

CILI ËSHTË VENDIMI PËRSA I PËRKET BURRAVE QË VENDOSIN UNAZË ARI?

Sipas fesë sonë mbajtja e unazave ari nga burrat është e ndaluar. Për të shpjeguar këtë temë mund të përmendim këto raste.

Sipas transmetimit të Abdullah bin Omerit (r.a) unaza e para që vendosi në gisht Resulallahu, (a.s.) ishte prej ari. *Sahabët gjetën nga një unazë ari dhe e vendosën në gisht për t'i ngjarë Atij. Kur e shikoi këtë gjë Pejgamberi ynë e nxori unazën e vet nga gishti dhe tha:*

"- Nuk do ta vendos kurrë më këtë unazë!.."

Edhe shokët e Profetit vepruan në të njëjtën mënyrë duke i nxjerrë nga gishti unazat." (Buhari, VII, 53; Ebu Davud, IV, 128.)

Abdullah bin Abbasi ka transmetuar:

"Një ditë Pejgamberi (a.s.), shikoi një unazë ari në gishtin e dikujt. Ia nxori nga gishti menjëherë dhe e hodhi duke i thënë:

"- Si ka mundësi që njëri nga ju merr një copë zjarri dhe e vendos në gishtin e tij?"

Kur iku Pejgamberi (a.s.), i thanë burrit:

"Merre unazën që Ai hodhi dhe shite atë në mënyrë që të përfitosh prej saj."

Ai iu përgjigj:

"- Jo, unë betohem në Allah se duke qenë se Pejgamberi salallahu (a.s.), e hodhi atë unazë unë nuk e marr më atë!.." (Muslim)

Ndërkohë nuk ka asnjë transmetim që të tregojë se ka ndalimi edhe për gratë në lidhje me vendosjen e unazave. Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Pambuku dhe ari janë të ndaluar për burrat e umetit tim dhe janë të lejuara për gratë e umetit tim." (Tirmidhiu, Libas, 1.)

Ditët e sotme na ofrojën shumë mundësi shkencore për të bërë kërkime në lidhje me këto çështje dhe përsëri ato na kanë treguar se të gjitha ligjet e islamit janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të jenë në dobi të njeriut. Sipas hulumtimeve të bëra, ari rrit sasinë e hormonit të estrogjenit, hormoni i feminilitetit. Përdorimi i arit nga burrit bën që tek ato të rriten tiparet femërore. Siç e dimë Islami e ka ndaluar përdorimin e arit shekuj më përpara para se të bëheshin këto kërkime shkencore.

Duhet të kemi parasysh se përdorimi i arit është i lejuar vetëm në ato raste kur përdoret për arsye

SHKRIMET NË UNAZAT E NJERËZVE TË MËDHENJ TË ISLAMIT

Edhe katër halifet përdornin unaza prej argjendi, në to ishin shkruar këto fraza:

Në unazën e Hz. Ebu Bekrit (r.a.), ishte shkruar: **"Sa i fuqishëm është Allahu"**

Në unazën e Hz. Omerit (r.a) ishte shkruar: **"Vdekja është e mjaftueshme si këshillë"**

Në unazën e Hz. Osmanit (r.a.), ishte shkruar: **"Ose do të tregohesh i duruar para problemeve dhe fatkeqësive ose do të pendohesh"**

Në unazën e Hz. Aliut (r.a.), ishte shkruar: **"Pasuria është pronë e Allahut."**

***

Në unazat e disa prej dijetarëve ishin këto shkrime:

Në unazën e imamit Ebu Hanife: **"Ose fol për të mirë ose hesht"**

Në unazën e Ebu Jusufit: **"Kush vepron duke ndjekur ndjenjat do të pendohet"**

Në unazën e imam Muhammedit: **"Ai që duron ka sukses"**

shëndetsore, për arsye shërimi. Si shembull mund të themi se përdorimi i dhëmbëve të mbështjellur me ar është i lejuar... Arfexhe bin Esad (r.a.), tregon:

"Në kohën e injorancës në luftën e Kulabit m'u dëmtua hunda prandaj më vendosën një hundë prej argjendi, por kjo filloi të mbante erë. Kur ia shpjegovë këtë gjëndje Pejgamberit (a.s.), më tha që të bëja një hundë prej ari." (Ebu Davud, Hatem 7; Tirmidhiu, Libas, 31; Nesai, Zinet 41.)

VENDOSJA E UNAZAVE PREJ ARGJENDI NGA BURRAT

Vendosja e unazave prej ari nga një burrë është e ndaluar, por nuk ka asgjë të keqe nëse një burrë vendos unazë prej argjendi. Sipas transmetimit të Enes bin Malik (r.a.), është shikuar shumë qartë përdorimi i unazës së argjentë nga Pejgamberi (a.s.). sikur përdorimi i unazës prej argjendi të mos ishte i lejuar, Pejgamberi ynë i nderuar nuk do ta kishte vendosur kurrë atë.

Duhet të kemi parasysh se nëse vendosja e unazës prej argjendi nuk është haram nuk mund të themi të njëjtën gjë për të gjithë sendet e tjera prej argjendi; pra nuk është e lejuar që një burrë të vendosë vathë, varëse, byzyluk apo diçka tjetër prej argjendi. Kur burri përdor diçka të tillë përveç unazës, ai i ngjan femrave. Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"- Allahu i mallkoftë gratë që përpiqen t'u ngjasojnë burrave dhe burrat që përpiqen t'u ngjasojnë grave!.."

Nga ky hadith kuptojmë se përdorimi i këtyre objekteve nga burrat është i ndaluar.

A MUND TË VENDOSIN UNAZË GRATË?

Islami është një fe e cila nuk vendos ndalime për të vështirësuar jetën e njerëzve vetëm nëse ato bien ndesh me parimet kryesore të saj. Gratë janë shumë të dhëna pas paraqitjes së jashtme, ato dëshirojnë që të duken bukur prandaj zbukurimi i grave me ar , argjend, gurë të çmuar apo gjëra të tjera të ngjashme është i lejuar. (Prof. Dr. Hajreddin Karaman, Fetva)

Nga ana tjetër nuk është e pranueshme që gruaja t'i shfaq këto objekte zbukurimi para burrave të huaj. Në Kuran thuhet:

"Thuaji besimtareve që të ulin shikimet e tyre *(nga e ndaluara)*, ***ta ruajnë nderin e tyre*** *(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)* ***dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme."*** (Nur, 31)

A KA NDONJË RËNDËSI NGA ANA E FESË MATERIALI NGA I CILI ËSHTË BËRË UNAZA?

Byrejde (r.a.), tregon:

Një njeri i cili mbante një unazë të bërë nga hekuri iu afrua Resulullahut (a.s.).

Kur e shikoi këtë unazë Pejgamberi tha:

"Pse shikoj që disa nga ju mbani një pjesë nga familja e zjarrit?!"

Burri menjëherë e nxorri unzën nga gishti dhe e hodhi atë.

Një ditë tjetër erdhi pranë Pejgamberit (a.s.) dhe në dorë mbante një unazë prej bakri.

Resulullahu (a.s.), i tha:

"-Pse dëgjoj tek ti erën e idhujve?!"

Më vonë ky njeri erdhi pranë Pejgamberit me një unazë floriri në dorë. Këtë herë Pejgamberi i tha:

"-Pse shikoj që ti po mban një zbukurim që i takon njerëzve të xhenetit?"

Burri e pyeti:

"Nga cili material duhet të jetë unaza ime atëherë?"

Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj:

"Le të jetë nga argjendi dhe të mos e kalojë peshën e 4.7 gram." (Tirmidhî, Libâs 43)

Tuba Sëkmen

Koha e faljes dhe mëshirës

Ramazani është muaji i shenjtë që na kujton të mirat që zotërojmë dhe na mëson si të jemi falënderues për këto. Në këtë muaj ne heqim dorë nga kënaqësitë materiale për të fituar kënaqësi shpirtërore. Ashtu si namazi edhe agjërimi na largon nga veprat e këqija dhe mëkatet; ai na afron me Allahun.

Ramazani është muaji i mëshirës dhe bujarisë. Ai na mëson të mendojmë për të varfrit dhe ta mbushim zemrën tonë me ndjenja dashurie për njerëzit e tjerë. Zemra pastrohet. Ndjenjat tona të mira forcohen.

Agjërimi është ilaçi i shumë sëmundjeve fizike dhe morale. Tepricat që ndodhen në trupin tonë hidhen jashtë me anë të agjërimit, nga ana tjetër agjërimi ndihmon në zvogëlimin e mëkateve. Njerëzit me anë të agjërimit arrijnë në një shkallë të tillë pastërtie duke u bërë të denjë për të kaluar nga dyert e xhenetit.

Agjërimi është mënyra më e mirë për t'i treguar dashurinë tonë Allahut, sepse njerëzit që agjërojnë vetëm për hir të Allahut e kushtëzojnë veten dhe qëndrojnë larg mëkateve dhe të këqijave. Njeriu që agjëron shpërblehet nga Allahu për këtë adhurim të bërë.

Siç ka thënë Shakiki Belhi:

"Kryerja e adhurimit ashtu siç duhet është një art i veçantë që kërkon aftësi të veçantë."

Mevlana i nderuar ka thënë:

"Ushqimi i vërtetë i një njeriu është drita e Allahut. Ushqimi i trupit me produkte të yndyrshme dhe të ëmbla nuk i bën mirë trupit. Ushqimi i njerëzve të mirë është dashuria hyjnore."

Bashkëshortja e nderuar e Pejgamberit tonë të nderuar, Hazreti Aishe ka thënë:

"Bëni përpjekje për të hapur derën qiellore!"

Njerëzit e pranishëm e kanë pyetur: "Si?"

Ajo i është përgjigjur: "- Duke qëndruar pa ngrënë dhe pa pirë!.."

Nga kjo kuptojmë se nuk është mirë ngrënia deri në mbingopje. Njerëzit e dashur të Zotit na kanë mësuar se duhet ngrënë pak, fjetur pak dhe folur pak.

Në këtë mënyrë para nesh hapet një derë e rëndësishme prej të cilës mund të fitojmë shumë. Le ta ruajmë gjuhën tonë nga gënjeshtrat, thashethemet, shpifjet dhe marrja nëpër gojë; le ta ruajmë zemrën tonë nga urrejtja, zilia, krenaria dhe ambicia e tepruar; le t'i ruajmë të gjitha gjymtyrët tona nga mëkatet dhe gabimet dhe duke shpresuar në faljen e gabimeve që kemi bërë le të mundohemi për të qëndruar të pastër dhe të drejtë.

Le ta mësojmë gjuhën tonë me dua, kërkesë për falje dhe me fjalën e dëshmisë. Gjatë këtij muaji të bekuar le të punojmë për të fituar xhenetin... Le të qëndrojmë larg mëkateve, në mënyrë që të shpëtojmë nga xhehenemi, le të bëjmë të mira aq sa kemi mundësi në mënyrë që t'i afrohemi xhenetit. Le të bëjmë përpjekje për të fituar duanë e njerëzve që vuajnë dhe që janë në gjendje të vështirë. Le të fitojmë sevape duke i ftuar në sofrat tona të Ramazanit njerëzit e varfër. Allahu na bëftë nga njerëzit që e kalojnë Ramazanin në mënyrën më të dobishme të mundur!

Amin!..

Nezhla Bash

FARA E RRUSHIT



Rrushi është një nga frutat që konsumohet më shumë në të gjithë botën. Rrushi emërtohet edhe me emrin: "Bima prej qumështi", ky përcaktim ka lindur duke marrë parasysh përbërjen e tij. Nga studimet e bëra është mësuar se edhe fara dhe bishti i tij kanë përfitime të mëdha biologjike. Kjo gjë na kujton që çdo gjë që ka bërë Allahu është për të mirën e njeriut.

Ne shqetësohemi nga fara dhe kemi dëshirë ta blejmë rrushin pa farë. Në fakt ajo farë që ne nuk e kemi qejf ka 60 vjet që përdoret në një mënyrë shumë efikase në Francë. Dobitë e mrekullueshme të bërthamës së rrushit janë zbuluar në vitin 1947 nga një profesor i universitetit të Bordosë; kimisti francez Jack Masquelier ishte një profesor pensionist i mjekësisë. Si fillim farat e rrushit iu dhanë gruas shtatzënë të dekanit të fakultetit nga burri i saj. Këmbët e saj të ënjtura u shëruan në dy ditë. Në vitin 1950 farat e rrushit filluan të përdoreshin për mbrojtjen të damarëve.

DOBITË E FARËS SË RRUSHIT

Fara e rrushit ka efekte shumë pozitive për damarët: Ajo siguron një qarkullim më të mirë të gjakut si në damarët e hollë ashtu edhe në ato të trashë.

Sipas një studimi të bërë në vitin 1995 në Itali 150 miligram fara rrushi kanë efekt më të shpejtë se ilaçet mbi dhimbjen, djegien dhe fryrjen e damarëve.

Sipas një studimi tjetër të bërë në Francë në vitit 1992 marrja e 300 miligram fare rrushi për 300 ditë përgjysmon dhimbjen, fryrjen dhe ngërçin e këmbës gjatë natës.

Shkurtimisht mund të themi se farat e rrushit janë të dobishme për parandalimin e forcimit të damarëve, tensionin e lartë dhe zvogëlojnë rrezikun e krizës së zemrës.

Fara e rrushit shërben si antioksidant dhe si parandaluese e kancerit: Si pasojë e reaksioneve kimike që ndodhin brenda trupit tonë dhe ajrit të ndotur që marrim nga jashtë krijohen radikale të lira (oksidante). Këto sjellin shumë dëme mbi organizmin tonë, që mund të ndikojnë edhe në shfaqjen e kancerit. Fara e rrushit me vetitë e saj antioksidante bën që këto të humbin efektin e tyre. Kjo veti e saj është 50 herë më e fuqishme se vitamina E dhe 20 herë më e fuqishme se vitamina C.

Dobia e bërthamës së rrushit në sy: Fara ndihmon në zhdukjen e njollave të gjakut në cipën e syrit dhe ndihmon në largimin e llamburitjes së syrit të shkaktuar nga dritat e shndritshme të natës. Gjithashtu ajo ndihmon në uljen e tensionit të syrit tek punonjësit që janë të detyruar që të kalojnë shumë kohë para kompjuterit dhe është vënë re që ajo ka rregulluar punën e retinës tek njerëzit që vuajnë nga miopia.

Efekti anti-plakje i farës së rrushit: Fara e rrushit ka efekt anti- plakje duke qenë se vepron kundër konsumimit të damarëve. Ajo forcon indet lidhëse duke e bërë lëkurën më të fortë dhe elastike. Fara e rrushit ngadalëson varjen e lëkurës duke bërë të mundur një paraqitje më rinore. Ka efekt edhe mbi njollat e moshës. Përveç këtyre ajo është e rekomanduar edhe për të sëmurët me ekzemë.

FARA E RRUSHIT KA EFEKT MBI TË SËMURËT ME HEMORROIDE DHE VARIÇE.

Si përdoret fara e rrushit?

Përveç përdorimit në gjendje natyrore ekzistojnë edhe këto mënyra të tjera:

- Në formë tablete

- Në formë pluhuri

- Duke ngrënë rrush të thatë.

Përveç këtyre fara e rrushit përdoret edhe në fushën e kozmetikës (krem, shampo apo sapun).

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHTIT 2005

KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR



CILËSI E VËRTETUAR

Jogurtat me përmbajtje
të kulturave *Bio Active*
Në Kosovë prodhohet
vetëm nga qumështorja "ABI"

Probiotic
drink

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address:"Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail:abi@abimilk.com

www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës
Numri i licencës : AVUK-001
"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033